Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
11

SHOKËT DHE JUSUF GËRVALLA

NUK KAM PRETENDIME
VËLLA I DHEMBJES KRENARE

1. E kujt është merita?
2. Më 14 dhjetor e braktisa Prishtinën dhe Kosovën
3. Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit
4. Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep
5. Tunelin e kalova me vrap
6. Gëzimi ynë s'pati kufi
7. Duke qenë njeri i përvuajtur dhe i thjeshtë
8. Do të iki me krahun tënd të bukës e me mezhdën e arës
9. Jusufi mori obligim që në Gjermani ta formoj degën e Lëvizjes
10. Unë e mora detyrën që të kaloja në Shqipëri
11. Ishte dita e 23 dhjetorit të vitit 1979
12. Në konsultim me Metush Krasniqin u vendos
13. Bir, në dorë të Zotit!

14. Pikërisht më 23 dhjetor 1979
15. Shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën
16. VËLLA I DHEMBJES KRENARE

17 Shkurti dhe 15 Maji 1982

1. "17 shkurti 1982" në librin "Vrasja e trefishtë"
2. 17 shkurti 1982 në dorëshkrimin e Osman Osmanit
3. Ballafaqimi i teksteve të vitit 2010 dhe1982
4. Ethem Çeku dhe simbolika e 15 Majit
5. Komunikata e 15 Majit 1982

ILIADA, ODISEJA DHE PJESA E TRETË

1. ILIADA
2. ODISEJA
3. SKENDERI I KROJEVE TË KRUJËS
4. "HUMBJA" DHE GJETJA E PJESËS SË TRETË

KUSH JANË ATA?

1. I rrënjosur thellë deri nëpër familje
2. Regjimi komunist
3. Ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore
4. Kush janë ata
5. Përpiqen të fitojnë kapital politik
6. Ju lutemi, na dërgoni materialet tuaja!
7. Amaneti dhe porosia
8. Për mua dhe vëllezërit e mi
9. Për nënën tonë
10. Për nënën Ajshe
11. Për shumë njerëz në Kosovë
12. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"

KAM PRETENDIME

1. Vrasësit nuk kanë pasur motive politike
2. Kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes
3. Kam heshtur rreth asaj që kam mësuar
4. Kam heshtur edhe prej moshës 10-18 vjeçare
5. Nuk duhet të heshtin dëshmitarët
6. Nuk duhet të heshtet as për atë burrë që e dërguan me armë tek Babi
7. Le ta thyejmë heshtjen së bashku…
8. Cila është ajo heshtje që duhet thyer?
9. Heshtja për të cilën kam folur nuk ka të bëjë me rrethanat e vrasjes
10. Kërcënimi i detyron këta njerëz të heshtin
11. Ka ardhur koha të mos heshtet
12. Kam pretendim që në Kosovë ka ardhur koha

ASNJËHERË NUK ARRITËN TË BËHEN SHOKË

1. Miku Kadri Zeka
2. Kadri Zeka, miku i ardhur
3. 28 Vjeçari ka pasur tensione me 36 vjeçarin
4. Mysafirit të tyre Kadri Zeka
5. Nuk është folur asnjëherë
6. Babi dhe Kadri Zeka

7. Kadri Zeka ishte shpesh i pranishëm
8. Babi angazhohej me ftesë të Kadriut
9. Liria botohej nga Kadri Zeka
10. Relatat mes Babit dhe Kadri Zekës
11. Asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë
12. Babi dhe Kadri Zeka në luftën e përbashkët
I DASHUR SHOK
JUSUF GËRVALLA DO TË MARRË IMPULSE TË REJA
SHOKU QË DIKUR MË DINTE PËR PRIJËS UJËRASH

NUK KAM PRETENDIME

Me serinë e librave të mi për Rilindasit e Shtutgartit, në qendër të të cilave është Jusuf Gërvalla, nuk kam pretendime të përzihem në çështjet e politikës aktuale. Veprat e mia kanë të bëjnë me ngjarje historike, kryesisht të kohës 1979-1985. Në shumë aspekte ato janë reagime të detyruara. Por ma merr mendja se edhe hapësira dhe shkaqet për të reaguar fatmirësisht janë zvogëluar. Kjo do të thotë se në këtë temë, me rënien e nevojave për reagime po u hapet shtegu vetëm agimeve të shumta të ndritshme, të cilat i meriton ajo kohë.

Vepra politike nga dora e Jusuf Gërvallës, vepra e tij dokumentare, politike, si vepër e një personi të organizuar, është çështje e përfunduar. Asaj nuk mund t'i shtohen fjalë të reja, as në formë reale as përmes *kontakteve spiritiste*. Ajo është e fiksuar në artikujt e revistave e gazetave në Gjermani, në letra, dhe nuk mund të ndryshohet, të mohohet, të lihet në heshtje me arsyetimin se nuk i ka ardhur koha, që është gati i njëjtë me qëndrimet renegatiste, se mund t'i ketë kaluar koha. Ajo nuk mund të vidhet, nuk mund të plaçkitet, dhe as të privatizohet për nevoja familjare e për pretendime familjare.

Veprat dokumentare për Jusuf Gërvallën dhe Rilindasit e Shtutgartit, kanë dokumentuar, jo vetëm në formë statike, por më duket edhe dinamike, pjesën më të madhe të asaj që ka ndodhur në rrethin e Shtutgartit, në vitet 1979-1985. Pamvarësisht nga ajo, se deri në cilën shkallë është arritur në këtë pikë, edhe në këtë kuptim, vjen momenti, kur në formë dokumentare, ajo çka ka pasur për t'u thënë edhe thuhet. Këtu e kam fjalën për veprën e gjallë dhe për jetën e Rilindasve, dhe jo për aventurat e *detektivëve* dhe *provokatorëve* të ndryshëm.

Mospërzierja në punët e të tjerëve, në zotshpillakun e familjeve të të tjerëve, në punën e partive politike, nuk ka të bëjë aspak me kopilitë e djallëzitë e stilit, se puna ime qëndron mbi çdo parti, apo e ka atë esencë që nuk është e partishme, nuk merr anën e askujt. Këto djallëzi e këto kopili i kam urrejtur tërë jetën, pasi me tërë qenien time jam munduar të tregoj se jam i partishëm dhe në anën e kujt qëndroj.

Në punën time, i kam studiuar me kujdes të madh dhe i kam kushtuar kohë të madhe të gjitha fakteve e dokumenteve që i kam pasur në dispozicion, dhe jam bazuar në to. Jam përpjekur me tërë qenien ta them të vërtetën, të vërtetën e një kohe, të vërtetën e një rrethi politik të caktuar. Nëse vepra e Jusuf Gërvallës dhe shokëve të tij, përmban esencën e një të vërtete të një kohe, dhe nëse ne shokët e tij kemi arritur ta kompletojmë dhe dokumentojmë atë të vërtetë, atëherë ajo, si e vërtetë e asaj kohe, ka mundësi të ketë

çka t'i thotë e t'i ofroj të vërtetës së secilës kohë, të jetë e pranueshme për të vërtetën e secilës kohë.

Vepra dokumentare nga dora e Jusuf Gërvallës është e përfunduar dhe asaj nuk i shtohen fjalë të reja. Veprat e karakterit dokumentar për Jusuf Gërvallën dhe Rilindasit e Shtutgartit, megjithëse ka hapësirë për çdo mendje kreative, megjithatë, në karakterin e tyre kanë hapësirë më të kufizuar dhe një ditë vjen momenti kur çdo pjesë e biografisë dhe veprimtarisë që paraqet interes për shoqërinë, bëhet e njohur. Ajo çka mbetet e pakufizuar, që mbetet temë përherë e hapur, është mundësia e interpretimeve të veprës së tij, sidomos asaj politike, në forma të ndryshme, programatike politike, apo kulturore dhe artistike.

Autori (Xhafer Durmishi), shkurt 2013

VËLLA I DHEMBJES KRENARE

Në historinë e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, raport i rëndësishëm është ai në mes Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës. Ai është konkret dhe i dokumentuar. Në këtë punim bëhen disa parashtrime që kanë të bëjnë vetëm me momentet e arratisjes së Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës. Parashtrimi im është ndarë në 16 pika-nëntituj. Pikat 2 - 7 përmbajnë ngjarje të dhëna nga Jusufi. Pikat 9-15 përmbajnë ngjarje, të dhëna nga Sabri Novosella. Për çështjen, shkaqet, e momentet e arratisjes, qysh nga Kosova, nuk kam biseduar as me Jusufin e as me Sabriun. Faqet e Ditarit të Jusufit, të cituara më poshtë, i kam pasur të njohura para shumë vitesh. Në vitin 2010, e lexova librin e Sabri Novosellës; *Rezistenca kosovare mes dy zjarresh*, Prishtinë 2010, që ishte botuar edhe më heret në formë fejtoni në gazetën Bota Sot. Në janar 2010 m'u dha mundësia që në librin e Faridin Tafallarit, *Me tre yjet e pavdekësisë*, (Tiranë, janar 2010), për herë të parë, t'i lexojë të gjitha letrat e Jusufit (me përjashtim të Raportit të korrikut 1981, të cilin Faridin Tafallari e botoi në www.albaniapress.com, më 2 tetor 2011) të dërguara Sabri Novosellës.

Publikimi i librit të Sabriut, *Rezistenca kosovare mes dy zjarresh,* më 2010 dhe 2012, dhe i letrave të plota të Jusufit për te, më 2010, nga Faridin Tafallari, në librin *Me tre yjet e pavdekësisë*, Tiranë 2010, kanë mundësuar parashtrimin e disa ngjarjeve si më poshtë.

1. E kujt është merita?
2. Më 14 dhjetor e braktisa Prishtinën dhe Kosovën
3. Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit
4. Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep
5. Tunelin e kalova me vrap
6. Gëzimi ynë s'pati kufi
7. Duke qenë njeri i përvuajtur dhe i thjeshtë
8. Do të iki me krahun tënd të bukës e me mezhdën e arës
9. Jusufi mori obligim që në Gjermani ta formoj degën e Lëvizjes
10. Unë e mora detyrën që të kaloja në Shqipëri
11. Ishte dita e 23 dhjetorit të vitit 1979
12. Në konsultim me Metush Krasniqin u vendos

13. Bir, në dorë të Zotit!
14. Pikërisht më 23 dhjetor 1979
15. Shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën
16. VËLLA I DHEMBJES KRENARE

1. E kujt është merita?

Xhafer Durmishi: *"Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ. Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi."* (Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985, Maj 1992; Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 326)

2. Më 14 dhjetor e braktisa Prishtinën dhe Kosovën

Jusuf Gërvalla: "*E diel, 30 dhjetor, 1979*
ora 00.45 Ludwigsburg

Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën. Aty nga ora 16, erdhën në „Rilindje" Suzana me Kadri Rexhën dhe më prunë lajme të hidhura.

Atë ditë herët në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën.

Unë, me Suzanën e me Kadriun, hymë në bufe të „Rilindjes" sa për të pirë nga një kafe, që ta merrja pak vetën nga pesha e hidhur e lajmeve, kur në bufe hynë dy nga punëtorët e SPB-së, që kishin bërë tek unë bastisjen (me dy të tjerë). Kërkonin prej meje makinën tjetër të shkrimit, atë të punës (makinën ilegale e kishin gjetur). Atë makinë e kisha në banesë të Muhamet Tërnavës, e Muhameti ishte zyrtarisht në Gjermani. Pasi nuk e gjetëm të vëllain, që të na e çelte derën e banesës, inspektorët e SPB-së shkuan dhe e morën një mjeshtër, e çelën derën me dhunë, e morën çantën, dhe ata i vunë derës dry të ri, e çelësat m'i dhanë mua.

Pastaj më çuan deri në banesë, ku i gjeta Bacën Mujë, Idrizin, Ferizin e Ramizin. Këta ndenjën sa ndenjën, e u çuan.

Unë e ndala dritën dhe ndenjëm ashtu në terr me Suzanën për ndonja një orë, duke u shtirë se po flemë (për ata që do të kenë përgjuar eventualisht përjashta). Më vonë u përshëndeta me Suzanën, duke i treguar se ndoshta shokët do të më këshillojnë të arratisem.

Ajo u pajtua, pa fjalë, dhe unë ika, duke i lënë fëmijët në gjumë. (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 245-246)

3. Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit

Jusuf Gërvalla: *"Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata.*

Kah ora dy pas mesnate, tashmë ditë e shtunë, i trokita në derë Skënder Blakajt. Me veturën e tij shkuam në Pejë, e morëm Salih Kastratin, dhe u nisëm për Jesenicë, në kufirin jugosllavo-austriak. Rrugës kaluam mirë. Ata më lanë në oborr të Bacit Haxhi, kështu ishim marrë vesh dhe shkuan." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 246)

4. Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep

Jusuf Gërvalla: "*Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep. Qëllimi ish që nga Jesenica të kontaktoja me Bardhin, që të vinte e të më merrte me vete. Por bllokun me numra telefonash e me adresa ia kisha lënë Suzanës, që ta bënte Bardhin me dije që të mos vinte në Jugosllavi, se ishte rrezik edhe për te, e kur pata dalë shtëpie s'më kishte shkuar mendja që do të ikja për në Gjermani (mendoja se do të ketë mundësi për Shqipëri).*

Në Jesenicë më ra të qëndroj prej të shtunës mbrëma deri të enjten në mëngjes. Bacit Haxhi ia tregova çështjen të martën dhe atë të martë dola prej banesës së tij dhe zura vend në një bujtinë, në Zhirovnicë.

Bardhi s'kishte sjellë me vete ndonjë dokument të vyer për mua, mirëpo, me ardhjen e tij, unë u çlirova shumë. Para dreke bëmë ca plane, më në fund vendosëm që për Austri të ikja më këmbë, nëpër tunelin që shpie nga Hrushica (4 - 5 km larg Jesenice) deri në Rozenbah të Austrisë.

Në orën 17,30 u ndalëm me veturë në rrugën automobilistike të Hrushicës, 30-40 km nga tuneli. U nisa. Bardhin e porosita që po s'iu ktheva për 10 minuta, të nisej edhe ai me veturë për në Austri, nëpër kalesën kufitare në Podkoren të Kranjska Gorës. Afër hyrjes në tunel, pasi përgjova mirë e s'diktova njeri ndër oborret e ndër shtëpitë pranë, m'u ndërsye një qen. Ia lëshova dritën e baterisë së dorës dhe hyra me vrap në tunel." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 246-247)

5. Tunelin e kalova me vrap

Jusuf Gërvalla: "*Tunelin, 8100 m, e kalova, së paku 70% të gjatësisë, me vrap. Ishte aksioni im i parë në jetë në të cilin kisha hyrë me rrezik 100% që ose të shpëtoj, ose të bie në burg, ose, madje, edhe të vritem.*

Pas guximit nistar, me të cilin i hyra rrezikut, zemra m'u bë zog dhe një frikë e papërjetuar kurrë ma kaploi të tërë qenien. Kurrë s'e kam marrë me mend që mund të jem aq i lig. Po ja që rrugën e kalova (sa isha unë duke ikur, nëpër tunel kaluan tre trena - elektrikë, për fat) dhe ia dola qëllimit.

Bardhin, sipas marrëveshjes, e prita te ura e parë e hekurudhës që pritej me rrugën automobilistike, 20-30 km nga dalja e tunelit. Fshati i parë që shihej nga ai vend në mal, ishte nja 500 m më poshtë. Prita afro një, një orë e gjysmë, kot. Atëherë iu drejtova me frengjishten time të mjerë të zotit të veturës së parë që kaloi atypari në një si depo-uzinë. Ai s'e dinte frengjishten, por për fat fliste sllovenisht gati më mirë se unë. Ai me çoi me veturë deri në Rosenbach (tetë km) ku u takuam me Bardhin, që ishte nisur kah vendi tek e prisja unë." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 247)

6. Gëzimi ynë s'pati kufi

Jusuf Gërvalla: "*Gëzimi ynë s'pati kufi.*

Bardhi ishte frikësuar shumë. Sa kish qenë duke ndenjur te vetura, matan kufirit në Hrushicë, pos të lehurave të qenit, kishte dëgjuar edhe një të shtënë dhe kishte parë të qarkullonte po në atë çast me shpejtësi automobilin e policisë jugosllave.

Doganierëve në kufirin austro-gjerman, Bardhi ua tregoi pasaportin e vet dhe një pasaportë të vjetër të një turku, ndërsa unë shtiresha se po fle në selinë e mbrame të automobilit.

Në Ludwigsburg, në banesë të Bardhit, arritëm nga ora katër e mëngjesit, ditën e premte, më 21 dhjetor, plot një javë pas arratisjes sime.

E hënë, 14 janar, ora 00,45 (Ludwigsburg)

Sot do të paraqitem me kërkesë për azil politik në policinë e Ludwigsburgut." (Vepra, vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 247-250)

7. Duke qenë njeri i përvuajtur dhe i thjeshtë

Letra Enver Hoxhës për strehim në Shqipëri

Jusuf Gërvalla: "*I dashur shoku Enver!*

...Unë, me të arritur në Ludvigsburg, i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej shokëve të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaport e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej shokëve të Ambasadës së përmendur.

Nga ajo kohë u bënë afro katër muaj dhe lidhur me kërkesën time nuk mora ndonjë përgjigje....

*Por**, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri.** Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver....*

Jam i vetëdijshëm edhe për disa probleme të pahijshme, që kanë shkaktuar disa kosovarë, duke dalë me qëllime të ulëta në territorin e RPS të Shqipërisë. Për fat, makinacionet e UDB-së, që në Kosovë e viset e tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë kanë bërë kërdinë në dëm të popullit tonë, në shtetin shqiptar s`kanë gjetur shesh për të bërë përshesh. Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurtë se unë s`do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës, që janë vënë në shërbim të armikut, por do të ndiqja shembullin e ca të tjerëve, si Ajet Haxhiu, Agim Gjakova e ndonjë tjetër të cilët kurdoherë kanë mbetur burra të ndershëm." (Letër e Jusuf Gërvallës, shënim i F. Tafallarit) (U botua për herë të parë së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

8. Do të iki me krahun tënd të bukës e me mezhdën e arës

Këta vargje i kam mbledhur nëpër veprën poetike të Jusuf Gërvallës.

Haj, sa heret kemi mbetë pa ty... baba!
Kujt t'ia la shpirtin peng që
vëllazënvet t'ua kthei tandin!?

Vllaut
E vështirë qenka andrra
që simbol ka të vërtetën.
E vështirë qenka kanga
që këndon për heshtjen!

Po s'paskam dijtë se qenka
ma e vështirë ndamja prej teje!

e unë po pres heshtjen tënde si kob po e pres
unë po vdes po vdes në pamundësinë time vëlla
thuaja me tundim qortimin me frymë bëje
se ***rrufe të forta po më presin*** *atje grykë shtegu*
do të iki me krahun tënd të bukës e me mezhdën e arës

po heshtjen vëlla si zgor do ta mbaj në bebëza
atje grykë shtegu i vetmuar si lisi majë mali
thuajse me tundim dashurinë e pashprehur me fjalë.

i dëgjoj do zëre frymësh që s'janë më
një hije dhe një kërrutë që përvidhet
tatpjetë shtegut për në log, o vëlla
po vij kaq i etur të të them pa fjalë
se zjarri që kall heshtja jote djeg valë

Sytë e tu qiell çerdhe e lumë i pakapërcyeshëm
ndërsa jam përgjumur përmbi tavolinë
im vëlla dhe fëmijëria ime pemën e kanë vjelë

Im vëlla të ka dashur të ka marrë dhe tash nuk je
as ti as ai s'jeni dridhmë plot fletë
nga fluturimi yt tash vetëm ngjyrë
dhe pluhur ka mbet'.

Kë zëvendësojë unë, vëlla. Dua të di
për dashurinë të flas
si e ndiej
Prandaj desha të bëhem poet, më ndjeni

9. Jusufi mori obligim që në Gjermani ta formoj degën e Lëvizjes

Sabri Novosella: "*Ne me këtë organizatë vepruan deri në vitin 1979, kur ndodhi një çast i dekonspirimit, me ç'rast u arrestuan Shefqet Jashari, Hysen Gërvalla e të tjerë. Pas një kohe jo shumë të gjatë kanosej rreziku që të arrestoheshim edhe Jusuf Gërvalla dhe unë kështu që, në konsultim me Metush Krasniqin u muar vendim që Jusufi të arratisej në Gjermani, pasi atje e kishte vëllaun, Bardhoshin, i cili poashtu ishte i organizuar në radhët e organizatës sonë. Jusufi mori obligim që në Gjermani ta formoj degën e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës*." (Drita,Trelleborg-Suedi, nr.9, 1997, faqe 15)

10. Unë e mora detyrën që të kaloja në Shqipëri

Zëri: Po Ju?

Sabri Novosella: "Unë e mora detyrën që të kaloja në Shqipëri, ku do t'i bëja dy kërkesa: së pari që atje të kërkoja formimin e degës së Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe nëse kjo nuk realizohej, atëherë të më bëhej e mundshme që nga Shqipëria të kaloj në ndonjë vend tjetër. Kështu edhe ndodhi." Me ndihmën e disa shokëve, emrat e të cilëve nuk mund t'i përmend për shkaqe të sigurisë së tyre, me sakrifica shumë të mëdha, e kalova kufirin ilegalisht dhe dola në Shqipëri." (Drita,Trelleborg-Suedi, nr.9, 1997, faqe 15)

11. Ishte dita e 23 dhjetorit të vitit 1979

Sabri Novosella: "*Ishte dita e 23 dhjetorit të vitit 1979. Isha i porositur nga Metush Krasniqi dhe shokë të tjerë që, në Shqipëri të pranoja të flisja vetëm me Ajet Haxhiun dhe Sali Shatrin.*" (Drita,Trelleborg-Suedi, nr.9, 1997, faqe 15)

12. Në konsultim me Metush Krasniqin u vendos

Sabri Novosella: "*Në fund të muajit dhjetor të vitit 1979, në orët e vona të një mbrëmjeje, erdhi te unë dr. Ramadan Xhema (pastaj ky emigroi në Amerikë!), duke ma kumtuar një lajm të keq. Më njoftoi se kishin qenë tek ai dy udbashë për kontrollim mjekësor në Spitalin e Prishtinës. Ai i kishte dëgjuar ata duke biseduar me gjysmë zëri:*

"Duhet të flejnë më herët sonte, sepse nesër në mëngjes ka me u burgos Sabri Novosella.

Ky ishte një sinjal shumë i qartë dhe tepër serioz për mua.

Në konsultim me Metush Krasniqin u vendos që, po të jetë e mundur, Jusufi të arratisej për në Gjermani ku e kishte të organizuar të vëllanë Bardhosh Gërvallën, me një grup të rinjsh që iu kishin bashkangjitur gjithandej. Ndërkaq, për mua u propozua të arratisem për në shtetin shqiptar, pasi që atje e ishte krijuar një lidhje. Kjo lidhje ishte krijuar nëpërmjet Mark Mërturit, i cili kishte qenë dy herë në Shqipëri te kusherinjtë e vetë, në Mërturaj të Malësisë së Madhe. Atje Marku kishte marrë lidhje me Ajet Haxhiun dhe Salih Shatrin, sipas udhëzimeve të udhëheqjes së LNÇKVSHJ-së, të përcjella nga unë, krah i së cilit ishte edhe vetë Marku.

Pra, përfundimisht u vendos që unë të arratisesha në Shqipëri dhe atje të bisedoja për çështje të organizatës vetëm me Ajet Haxhiun dhe Salih Shatrin, të cilëve do t'u shtrohen dy kërkesa: e para që të organizohet Dega e LNÇKVSHJ-së në Shqipëri nga Ajeti, Salihu, Hysen Bukoshi, Ali Boletini dhe unë dhe e dyta, nëse nuk lejohet kërkesa e parë, atëherë t'i mundësohet Sabriut dalja në ndonjë shtet nga ku do të mund ta vazhdoja aktivitetin.

Atë natë unë së bashku me nënën Naile, u larguam nga shtëpia dhe u vendosëm në banesën e Fadil Mehmetit. Në shtëpi e kisha lënë parullën: "Nëse vijnë udbashët për të më burgosur, le të thërrasin në telefon dhe të pyesin se si është nëna"? Nëse nuk bëhet thirja, kjo nënkupton që nuk kanë ardhur të më arrestojnë. Mirëpo, në orën pesë të mëngjesit u dëgjua zilja e telefonit. Ky ishte lajmi i keq për mua. UDB-a kishte shkuar në shtëpinë e tij për ta arrestuar. U përgatitëm shpejt dhe dolëm nga banesa." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 126-129)

13. Bir, në dorë të Zotit!

Sabri Novosella: "*Nëna Naile nuk mundi të më përcillte deri në fund të shkallëve, por ajo e përshëndeti duke ma dhënë bekimin: "Bir, në dorë të Zotit"!*

Këto fjalë të nënës Naile, m'i rikujtuan fjalë që nëna gjithmonë m'i thoshte gjatë vizitave në burgje: "M'u kthefsh me faqe të bardhë, o bir"!

Ngado që shkova nëpër botë duke i kaluar tetë herë kufijtë e shteteve ilegalisht, ngado që e hodha hapin, më dukej se Zoti po e realizonte lutjen e nënës Naile dhe po m'i hapte rrugët pa pengesa. Dhe kështu asnjëherë nuk pata problem në kufijtë që ishin të veshur e ngjeshur edhe me tela gjemborë, besa edhe të minuar nën dhe e sipër dheut." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 129-130)

14. Pikërisht më 23 dhjetor 1979

Sabri Novosella: *"Shefiku, i cili i kishte disa fëmijë, gruan në spital të sëmurë, më strehoi dhe u kujdes për mua disa ditë derisa në një mbrëmje erdhi Fuad Hajdini me një makinë dhe u nisëm për në Gjakovë, te Mark Mërturi. Marku nuk e njihte Fuadin, por as Fuadi nuk e njihte Markun. Pas një pushimi të shkurtër, Fuadi u nisë për në Prishtinë. Marku i tha të shoqes, Terezes, që të përgatitet, se duhet të shkojmë me Sabriun. Dhe doli nga shtëpia. Pas pak kohësh u kthye me një njeri me një makinë. Marku këtë "të panjohrin" për mua e thërriste "kumbar". Kështu, me një anëtar të organizatës, me shumë rreziqe dhe vështirësi më përcolli përmes maleve të larta kah gryka e cakorret e me rreziqe të shumta. Më në fund, pikërisht me 23 Dhjetor 1979, ku pas 12 orë ecjesh në këmbë nëpër mot dhe terren tepër të vështirë, qëndruam deri në orët e vona në fshatin Gurrec, në shtëpinë e Terezës, te nëna e gruas së Mark Mërturit. Unë kalova matanë kufirit, kurse Marku me një anëtar tjetër të organizatës që më përcollën, u kthyen."* (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 130).

15. Shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën

Selatin Novosella: *"Duke folur për rrethanat e kohës dhe përpjekjet organizatave të ndryshme të bënin një bashkim veprues, Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "**Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën, i cili tashmë, bashkë me të vëllanë Bardhoshin, dhe të shoqen Suzanën, e kishin formuar Degën e Lëvizjes në Gjermani."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla*: "Dhe kështu, për kaq kohë sa njihemi- e nuk është pak po më **se dhjetë muaj**-ne të shumtën i kemi rënë kush thumbit e kush patkoit. Mendoj se kjo e ka arsyen e vet objektive. Ti ke njerëzit e tu, me të cilët, sipas mendjes sime, ke vështërsi në realizimin e kontakteve për shkak të largësisë. Kam përshtypjen se, pos kësaj, edhe me ta*

ke mospajtime dhe sygjerime e urdhrave të tyre s'të fle në hatër tu përmbahesh gjithmonë. ***Unë nga ana tjetër i kam humbur të gjitha lidhjet me njerëzit e mi dhe për çdo hap që bëj kam stërngarkime, sepse nuk e di në mos bej gjësend, që nuk përputhet me luftën aktuale, që bëjnë ata në vendlindje****. Kjo është një tragjedi vetvetiu. Kurse tragjedia tjetër është se edhe unë edhe ti, në këto kushte, ndiejmë pasiguri në një pikë: që përfaqësojmë..." (Letër Ibrahim Kelmendit, nëntor 1980;* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Selatin Novosella:*" ...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "****Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën..."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Bardhosh Gërvalla: "*Herrn Nijazi Saracoglu, Mahmut Pasa Çadesi 82, TR-ISTAMBUL, Türkei*

I dashur Shoku Nijazi, dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gëzuar, ***sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po presim ndonjë lajm nga shoku Bashkim Prishtina (Sabri Novosella-shën i Xh. D.)****, për të cilin ju mund ta dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllau im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t`ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prapë këndej.*
*... Me Shabanin (*Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 Munchen - shën i Xh. D.) *u njohëm para dy javësh në panairin e artizanatit, ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Ai edhe na dha adresën dhe telefonin tuaj. ... Kishte me qenë mirë sikur edhe* ***Bashkimi*** *të na shkruajë sa më parë. Në fund po iu përshëndes ju me gjithë familjen dhe dashamirët tuaj. Bardhosh Gërvalla, Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany,*
Tel. qyteti Ludwigsburg 7141/26091" (U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Selatin Novosella:*" ...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "****Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën..."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla: "*Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se,* ***duke qenë krejt i vetmuar****, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Vllaut
E vështirë qenka andrra
që simbol ka të vërtetën.

E vështirë qenka kanga
që këndon për heshtjen!

Po s'paskam dijtë se qenka
ma e vështirë ndamja prej teje!
Jusuf Gërvalla

16. VËLLA I DHEMBJES KRENARE

Sabri Maxhuni - Novosella
(Kushtuar Heroit Jusuf Gërvalla)

Sytë i mbylle ashtu siç i ka hije trimit
Ne mbetëm me dy dëshira në gji
Mbi kullat tona të mos valoj flamur i huaj
Dhe ta japim frymën e fundit ashtu si e dhe Ti.
Këto dy dëshira Ti gjithnjë i pate
Pa arrirë në të parën, në kandil u shndërrove
Që ne sot rrugën na e ndriçon,
Këtë rrugë që së bashku e rrahëm,
Kësaj rruge që s'do t'i ndahemi,
Kësaj rruge të ndriçuar si Ti dhe nga ata si Ti.
Kjo rrugë do të na qoj në një ditë
Ku do t'i hudhemi njëri-tjetrit në përqafim
E lotët e gëzimit do t'i thithim në atë kremtim
Edhe se pranvera do varre do t'i gjelbëroj.
Kështu ka qenë dhe është jeta jonë,
Kështu është pasuruar trualli ynë
Me vëllezër të dhembjes krenare
Që themelet kullave tona ua forcuan,
Që ngjyrën flamurit tonë ia kuqëzuan,
Që shqiponjës dykrenare krah i dhanë
Të valoj mbi kullat tona anembanë...
(Shkruar në Adapazar - Turqi, 1982)

17 Shkurti dhe 15 Maji 1982

1. "17 shkurti 1982" në librin "Vrasja e trefishtë"
2. 17 shkurti 1982 në dorëshkrimin e Osman Osmanit
3. Ballafaqimi i teksteve të vitit 2010 dhe1982
4. Ethem Çeku dhe simbolika e 15 Majit
5. Komunikata e 15 Majit 1982

1. "17 shkurti 1982" në librin "Vrasja e trefishtë"

"Dokumenti i 17 shkurtit 1982", i botuar në vitin 2010, në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 125-126:

D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe KQ të PKMLSHJ.

Në kryeqytetin e Turqisë, në Ankara, më 17 shkurt 1982 rreth orën 21.00 filluan bisedimet për bashkimin e organizatave simotra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ.
Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësonin Sabri Novosella (Mërgimi) dhe Xhafer Durmishi (Shpendi).

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësonin Abdullah Prapashtica (Kushtrimi) dhe Osman Osmani (Halimi). Në këtë mbledhje merr pjesë edhe drejtuesi i Organizatës së Rinisë dhe njëherësh anëtar i KQ të PKMLSHJ Faton Topalli (Qemali) si përfaqësues i këtyre bisedimeve. Në vrazhdën e këtyre bisedimeve delikate, përfaqësuesi i PKMLSHJ-së Osman Osmani (Halimi),doli me propozimin kompromis që dy organizatat të bashkohen në "LËVIZJEN PËR REPUBLIKËN SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSSHJ);

– LRSSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një Komitet si organ qendror, revistë apo gazetë.

– LRSSHJ të formoj organizatat e veta të brendshme; (ashtu siç i kanë Republikat tjera në Jugosllavi).

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Xhafer Durmishi (Shpendi,) u pajtua me këtë propozim.

Pas tij fjalën e morri përfaqësuesi i PKMLSHJ Abdullah Prapashtica (Kushtrimi) i cili deklaroi:

– Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parasheh ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Dhe së fundi, përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Sabri Novosella (Mërgimi) deklaroi:,

– Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Osman Osmani (Halimi) i përkrahur edhe nga Xhafer Durmishi (Shpendi) dhe Abdullah Prapashtica (Kushtrimi), kam bindjen se emërtimi i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë Komitetin e LRSSHJ-së. Ai më tej propozoi:

– Të formohet një komision nga anëtarët e këtij Komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSSHJ-së.

– Organi i LRSSHJ-së të mbetët "Zëri i Kosovës" dhe puna të vazhdoj me tekniken e përsosur të Jusuf Gërvallës.

V E N D I M

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ).

2. Organizatat e brendshme do të organizohen sipas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

3. Të formohet komisioni nga anëtarët e Komitetit Drejtues për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSSHJ.

4. Në Komitetin Drejtues të hyjnë nga tre anëtarë të dy Komiteteve Qendrore të mëparshme, ndërsa dy KQ në përbërje të plotë, të hyjnë në Kuvendin e LRSSHJ.

5. Organi i LRSSHJ të jetë "Zëri i Kosovës" kurse organi i Rinisë të quhet "Republika".

6. Procesi i bashkimit konsiderohet i përfunduar kur në LRSSHJ të bashkohet edhe OMLK!

Ankara, më 17 shkurt 1982
Qemajli (Faton Topalli)
Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Mërgimi (Sabri Novosella)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)
(Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 125-126)

Sabri Novosella: *"Duke pasur parasysh se Jusuf Gërvalla u vra me organin e LNÇKVSHJ-së në dorë, Xhafer Durmishi propozoi që organi i LRSHJ-së të emërtohet "Zëri i Kosovës"."* (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 195)

2. 17 shkurti 1982 në dorëshkrimin e Osman Osmanit

Dokumenti i bashkimit i 17 shkurtit 1982 i shkruar me dorën e Osman Osmanit (d.m.th. jo me makinë shkrimi por me dorë) nga shkurti 1982:

D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësojnë anëtarët e KQ Mërgimi (Sabri Novosella) dhe Shpendi (Xhafer Durmishi).

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësojnë Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) dhe Halimi (Osman Osmani), anëtar të KQ. Në këtë mbledhje merr pjesë edhe anëtari i KQ të PKMLSHJ Qemali (Faton Topalli) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Pas afër tre muajsh bisedime dolëm me propozime konkrete.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin "LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSHJ).

LRSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një KQ, një organ qendrore.

LRSHJ të formoj organizatat e veta të brendshme; të gjitha organizatat që i ka një Republikë në Federatën Jugosllave.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Shpendi (Xhafer Durmishi) deklaroi:

-Pajtohem që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj si e tillë deri në momentin kur të realizohet kërkesa për formimin e Republikës.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) deklaroi:

-Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parashef ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga Shpendi (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin "Zëri i Kosovës", pasi ky emër shpreh Zërin e Kosovës, kurse organi i rinisë të LRSHJ të quhet "Republika".

Në lidhje me këtë propozim Halimi deklaron:

- Jam i mendimit që këto dy organe të ekzistojnë por me një renditje tjetër. Për arsye se qëllimi i LRSHJ është Republika edhe organi i LRSHJ të jetë me po këtë emër, kurse si organe të rinisë së LRSHJ, pasi rinia jonë ndjek Zërin e popullit të Kosovës (në kuptimin e gjerë) emri i organit të rinisë së LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës", dhe shtoi: Në udhëheqësi të LRSHJ të hyjnë edhe udhëheqësitë e dy organizatave tjera të njohura OMLK dhe FKP me bashkimin e tyre në LRSHJ.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ shton (Kushtrimi):

- Sa i përket emrit të organit qendror të LRSHJ jam i mendimit se mund të botohet me emrin "Zëri i Kosovës" apo "Republika", pasi që jam i mendimit që edhe njëra edhe tjetra e kanë kuptimin e Zërit të popullit shqiptar në Jugosllavi.

Sa i përket organeve të organizatave tjera të LRSHJ ato vetë të caktojnë emrin e organeve të tyre.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ, Shpendi në lidhje me këtë problem deklaron:

- Duke patur parasysh se vet LRSHJ ka të bëjë me Republikë, ky titull të sintetizohet me kërkesën për Republikë. Mendoj se është e drejtë, kur të kihet parasysh se veç ekziston një organ për "Republikën e Kosovës" të cilën nesër mund ta kemi në radhët tona, organi qendror të quhet "Zëri i Kosovës".

Përfaqësuesi i PKMLSHJ, Qemajli deklaron:

– Edhe pse në këtë mbledhje marrë pjesë si përcjellës i bisedimeve, jap mendimin tim në lidhje me çështjen e bashkimit. Pajtohem plotësisht që organizata e përbashkët të quhet LRSHJ dhe që brenda saj sipas mundësive të organizohen të gjitha organizatat që ka një republikë në federatën jugosllave. Në lidhje me organin e LRSHJ

jam i mendimit që organi të quhet "Zëri i Kosovës". Për emrin e organeve të organizatave tjera vendosin vet organizatat.

Mërgimi shton:

– Të lihet mundësia, gjegjësisht t'u bëhet thirrje edhe të gjitha organizatave, grupeve patriotike e revolucionare që veprojnë në tokat shqiptare në Jugosllavi të i bashkohen LRSHJ.

Me këtë propozim, d.m.th. për thirrje që t'i bashkohen LRSHJ të gjitha organizatat dhe grupet patriotike revolucionare pajtohen të gjithë përfaqësuesit.

V E N D I M

I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. Organizatat e brendshme do të organizohen simbas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

3. Më vonë të formohet komisioni nga anëtarët e KQ për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSHJ.

4. Në KQ të hyjnë anëtarët e dy KQ të mëparshme në përbërje të plotë.

5. Udhëheqja e KQ të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme të KQ.

6. Organi i LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës".

Qemajli (Faton Topalli)
Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)
Mërgimi (Sabri Novosella)

Ky Dokument i shkurtit të vitit 1982, i shkruar me dorën e Osman Osmanit, pa asnjë shkurtim e ndryshim, botohet për herë të parë. Dokumenti është botuar pjesërisht në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218. Kompleti i këtij origjinali gjendet në arkivin e Faridin Tafallarit.

3. Ballafaqimi i teksteve të vitit 2010 dhe 1982

Së pari me *shkronja kursive jepet teksti i vitit 2010***,** i botuar në librin: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010 (faqe 125-126) dhe pastaj teksti nga Dokumenti i shkurtit të vitit ***1982 me germa kursive të trasha***, i shkruar me dorën e Osman Osmanit, pa asnjë shkurtim e ndryshim. Dokumenti i shkruar me dorën e Osman Osmanit, është teksti origjinal, që gjendet në arkivin e Faridin Tafallarit. Këto dokumente, teksti origjinal në dorëshkrim (i shkruar me dorë dhe jo me makinë shkrimi) të Osman Osmanit nga shkurti 1982, dallohet tepër nga teksti që është botuar në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, më 2010. Nga kjo rrjedh se teksti i botuar në librin "Vrasja e trefishtë" është falsifikim.

Krahasimet:

D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe KQ të PKMLSHJ.

D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

Në kryeqytetin e Turqisë, në Ankara, më 17 shkurt 1982 rreth orën 21.00 filluan bisedimet për bashkimin e organizatave simotra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ. Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësonin Sabri Novosella (Mërgimi) dhe Xhafer Durmishi (Shpendi).

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësojnë anëtarët e KQ Mërgimi (Sabri Novosella) dhe Shpendi (Xhafer Durmishi).

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësonin Abdullah Prapashtica (Kushtrimi) dhe Osman Osmani (Halimi). Në këtë mbledhje merr pjesë edhe drejtuesi i Organizatës së Rinisë dhe njëherësh anëtar i KQ të PKMLSHJ Faton Topalli (Qemali) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësojnë Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) dhe Halimi (Osman Osmani), anëtar të KQ. Në këtë mbledhje merr pjesë edhe anëtari i KQ të PKMLSHJ Qemali (Faton Topalli) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Në vrazhdën e këtyre bisedimeve delikate, përfaqësuesi i PKMLSHJ-së Osman Osmani (Halimi),doli me propozimin kompromis që dy organizatat të bashkohen në ''LËVIZJEN PËR REPUBLIKËN SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI'' (LRSSHJ);

Pas afër tre muajsh bisedime dolëm me propozime konkrete.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin ''LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI'' (LRSHJ).

– LRSSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një Komitet si organ qendror, revistë apo gazetë.

LRSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një KQ, një organ (revistë, gazetë) qendrore.

– LRSSHJ të formoj organizatat e veta të brendshme; (ashtu siç i kanë Republikat tjera në Jugosllavi).

LRSHJ do të formoj organizatat e veta të brendshme; të gjitha organizatat që i ka një Republikë Federative Jugosllave.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Xhafer Durmishi (Shpendi,) u pajtua me këtë propozim.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Shpendi (Xhafer Durmishi) deklaroi:

-Pajtohem që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj si e tillë deri në momentin kur të realizohet kërkesa për formimin e Republikës.

Pas tij fjalën e morri përfaqësuesi i PKMLSHJ Abdullah Prapashtica (Kushtrimi) i cili deklaroi:

– Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parasheh ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) deklaroi:

-Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parashef ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Dhe së fundi, përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Sabri Novosella (Mërgimi) deklaroi:,

– Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Osman Osmani (Halimi) i përkrahur edhe nga Xhafer Durmishi (Shpendi) dhe Abdullah Prapashtica (Kushtrimi), kam bindjen se emërtimi i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë Komitetin e LRSSHJ-së. Ai më tej propozoi:

– Të formohet një komision nga anëtarët e këtij Komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSSHJ-së.

– Organi i LRSSHJ-së të mbetët "Zëri i Kosovës" dhe puna të vazhdoj me tekniken e përsosur të Jusuf Gërvallës.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga Shpendi (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin "Zëri i Kosovës", pasi ky emër shpreh Zërin e Kosovës, kurse organi i rinisë të LRSHJ të quhet "Republika".

Në lidhje me këtë propozim Halimi deklaron:

- Jam i mendimit që këto dy organe të ekzistojnë por me një renditje tjetër. Për arsye se qëllimi i LRSHJ është Republika edhe organi i LRSHJ të jetë me po këtë emër, kurse si organe të rinisë së LRSHJ, pasi rinia jonë ndjek Zërin e popullit të Kosovës (në kuptimin e gjerë) emri i organit të rinisë së LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës", dhe shtoi: Në udhëheqësi të LRSHJ të hyjnë edhe udhëheqësitë e dy organizatave tjera të njohura OMLK dhe FKP me bashkimin e tyre në LRSHJ.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ shton (Kushtrimi):

- Sa i përket emrit të organit qendror të LRSHJ jam i mendimit se mund të botohet me emrin "Zëri i Kosovës" apo "Republika", pasi që jam i mendimit që edhe njëra edhe tjetra e kanë kuptimin e Zërit të popullit shqiptar në Jugosllavi.

Sa i përket organeve të organizatave tjera të LRSHJ ato vetë të caktojnë emrin e organeve të tyre.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ, Shpendi në lidhje me këtë problem deklaron:

- Duke patur parasysh se vet LRSHJ ka të bëjë me Republikë, ky titull të sintetizohet me kërkesën për Republikë. Mendoj se është e drejtë, kur të kihet parasysh se veç ekziston një organ për "Republikën e Kosovës" të cilën nesër mund ta kemi në radhët tona, organi qendror të quhet "Zëri i Kosovës".

Përfaqësuesi i PKMLSHJ, Qemajli deklaron:

– Edhe pse në këtë mbledhje marrë pjesë si përcjellës i bisedimeve, jap mendimin tim në lidhje me çështjen e bashkimit. Pajtohem plotësisht që organizata e përbashkët të quhet LRSHJ dhe që brenda saj sipas mundësive të organizohen të gjitha organizatat që ka një republikë në federatën jugosllave. Në lidhje me organin e LRSHJ jam i mendimit që organi të quhet "Zëri i Kosovës". Për emrin e organeve të organizatave tjera vendosin vet organizatat.

Mërgimi shton:

– Të lihet mundësia, gjegjësisht t'u bëhet thirrje edhe të gjitha organizatave, grupeve patriotike e revolucionare që veprojnë në tokat shqiptare në Jugosllavi të i bashkohen LRSHJ.

Me këtë propozim, d.m.th. për thirrje që t'i bashkohen LRSHJ të gjitha organizatat dhe grupet patriotike revolucionare pajtohen të gjithë përfaqësuesit.

V E N D I M

V E N D I M

I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ).

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. Organizatat e brendshme do të organizohen sipas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

2. Organizatat e brendshme do të organizohen simbas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

3. Të formohet komisioni nga anëtarët e Komitetit Drejtues për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSSHJ.

3. Më vonë të formohet komisioni nga anëtarët e KQ për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSHJ.

4. Në Komitetin Drejtues të hyjnë nga tre anëtarë të dy Komiteteve Qendrore të mëparshme, ndërsa dy KQ në përbërje të plotë, të hyjnë në Kuvendin e LRSSHJ.

4. Në KQ të hyjnë anëtarët e dy KQ të mëparshme në përbërje të plotë.

5. Organi i LRSSHJ të jetë "Zëri i Kosovës" kurse organi i Rinisë të quhet "Republika".

5. Udhëheqja e KQ të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme të KQ.

6. Procesi i bashkimit konsiderohet i përfunduar kur në LRSSHJ të bashkohet edhe OMLK!

6. Organi i LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës".

Ankara, më 17 shkurt 1982
Qemajli (Faton Topalli)
Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Mërgimi (Sabri Novosella)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)

Qemajli (Faton Topalli)
Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)
Mërgimi (Sabri Novosella)

4. Ethem Çeku dhe simbolika e 15 Majit

Ethem Çeku: *""Zëri i Kosovës" si organ i organizatës unike mbeti zëdhënësi më i denjë i jetësimit të luftës për liri". – Shih, Dokumenti mbi themelimin e LRSHJ-së, më 15 maj 1982. Ky dokument mban datën "15 maj", simbolikën më domethënëse të ngadhënjimit të botës demokratike mba nazifashizmin në përgjithësi, synim ky që ishte drejtuar edhe kah çlirimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të robëruara nga kolonializmi jugosllav nga viti 1912."* (Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë, Prishtinë 2003, faqe 226)

Mehmet Hajrizi (Strofci): *"Pas rënies së Kadri Zekës, Hasan Malaj dhe veprimtarët e tjerë e autorizojnë Xhafer Shatrin, i cili pas arratisë nga burgu kishte arritur në mërgatë, për ta përfaqësuar OMLK-në në marrëveshjen e bashkimit të organizatave. Më 15 maj 1982 është mbajtur mbledhja për bashkim në fshatin Lanovil, afër Bielit, në banesën e Hasan Malajt. Nga ana e OMLK-së ka marrë pjesë Xhafer Shatri, nga ana e LNÇKVSHJ-së, Skënder Durmishi, kurse nga ajo e PKMLSHJ-së, Osman Osmani. Në atë mbledhje është arritur bashkimi dhe* ***prej asaj date organizata*** *është quajtur "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi" (LRSSHJ), kurse organi i saj "Zëri i Kosovës."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 389)

Shefqet Jashari (Strofci): "Kam lindur më 15 maj 1944 në fshatin Strofc, KK Vushtërri."

Madeleine Albright: "Kam lindur si Marie Jana Korbelová më 15 maj 1937 në Prag."

5. Komunikata e 15 Majit 1982

"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***NË NJË TË VETME****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit, përfaqësuesit e tri organizatave në mes tjerash morën këto vendime e qëndrime:

KOMUNIKATË

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi(LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave në një të vetme. Pas arritjes së bashkimit u vendosë që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Në ndërkohe bisedime u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës(OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit përfaqësuesit e të tri organizatave me këtë rast pos tjerash, morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi;
2. LRSH-ja si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar në Jugosllavi, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës dhe terrorit serbomadh janë detyruar t'i lënë trojet e veta të stërlashta.
3. LRSHJ-a do të luftojë për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilin duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare dhe për realizimin e këtij qëllimi do te sherbehet me te gjitha mjetet qe lejon etika revolucionare:

Kjo Komunikatë u daktilografua, u shtyp dhe u shpërnda nga Xhafer Shatri, në të njëjtën fletë (së bashku) me thirrjen - KUSHTRIMIN- e demonstratës së Bernit, të 26 qershorit 1982

1. Që organizata e re të pagëzohet ”Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. LRSHJ-a si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës e terrorit serbomadh janë detyruar t'i lëshojnë trojet e veta të stërlashta.

3. LRSHJ-a do të luftoj për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare, dhe për realizimin e këtij qëllimi do të shërbehet me të gjitha mjetet që lejon etika revolucionare, duke u nisur nga bindja politike e gjer tek revolucioni i armatosur, po që se e kërkon nevoja.

4. LRSHJ-a është thellësisht e bindur se duke luftuar për Republikën Shqiptare në kuadrin e Federatës Jugosllave do t'i kontribuoj ruajtjes dhe forcimit të bashkimit dhe vëllazërimit të mirëfilltë në mes popujve të Jugosllavisë. Si përfaqësuese e vetme e popullit shqiptar në shtetin jugosllav, LRSHJ-a konsideron se lufta e saj e drejtë i shërben edhe forcimit të unitetit të Federatës Jugosllave, ruajtjes së paqes në Ballkan dhe stabilitetit të përgjithshëm në Evropë e më gjerë.

5. LRSHJ-a llogaritë në ndihmën dhe përkrahjen e të gjitha forcave progresive të Jugosllavisë, të cilave u propozon luftë të përbashkët kundër forcave hegjemoniste, kolonialiste, shoviniste dhe forcave tjera reaksionare në Jugosllavi, të cilat sot kanë pozita dominuese në të gjitha strukturat e shtetit dhe si të tilla paraqesin rrezik permanent për të ardhmen e Jugosllavisë, për perspektivën e popujve që jetojnë në te dhe për paqen në këtë regjion.

6. LRSHJ-a me të gjitha forcat do të luftoj kundër çdo shovinizmi e separatizmi, sepse edhe këto izma reaksionare, që mund të paraqiten edhe tek ndonjë shqiptar, e dëmtojnë unitetin e Jugosllavisë dhe vetvetiu edhe luftën e drejtë që bënë populli ynë.

7. LRSHJ-a përshëndet qëndrimin e drejtë të të gjithë opinionit progresiv ndërkombëtar, që u solidarizua dhe po solidarizohet me kërkesën e drejtë të popullit tonë për Republikën e vet në kuadrin e Federatës Jugosllave.

8. Përshëndetet qëndrimi i PPSH dhe i qeverisë shqiptare ndaj kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi për konstituimin e Republikës së vet në kuadrin e Federatës Jugosllave, me çka dëshmon interesimin e vet për këtë pjesë të kombit dhe prinicipialitetit të politikës së jashtme ndaj RSFJ, ku respektohen me përpikmëri parimet e moscënimit të sovranitetit dhe integritetit territorial, mospërzierjes në punët e brendshme, respektimit reciprok dhe barazisë së plotë në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ruajtjes së fqinjësisë së mirë, duke qenë gjithmonë në gatishmëri të plotë të mbrojë interesat e pjesë së kombit brenda normave dhe ligjeve ndërkombëtare.

9. LRSHJ-a u bënë thirrje të gjitha grupeve ekzistuese dhe individëve që luftojnë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi që t'i bashkohen Lëvizjes për Republikë.

10. LRSHJ-a që tash distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë terrorizmi dhe s'do t'ua shtrijë dorën e pajtimit individëve që i kanë duart e zhytura me gjakun e popullit. Gjithashtu Lëvizja s'do të bashkëpunojë asnjëherë me rrymat e organizatat politike që mbajnë vulën e tradhtisë, apo kanë qëllim ta rrezikojnë pavarësinë e Jugosllavisë.

11. Organ qendror i LRSHJ-së do të jetë ”Zëri i Kosovës”.

12. LRSHJ-a ua bënë me dije si OKB-së ashtu edhe qeverive të të gjitha shteteve që janë për paqe, liri dhe demokraci në botë, se pa iu njohur popullit shqiptar në Jugosllavi statusi i kombit dhe e drejta e patjetërsueshme e tij për Republikën e vetë në kuadrin e Federatës Jugosllave; pa u liruar pa asfarë kushti të gjithë të burgosurit politik dhe pa mundësimin e kthimit në vendlindje të të gjithë atyre që luftuan për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, LRSHJ-a nuk do të qetësohet kurrë.

RROFTE REPUBLIKA SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!
RROFSHIN TE GJITHE POPUJT E RSFJ!
RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKE!
Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ"

ILIADA, ODISEJA DHE PJESA E TRETË

HISTORIA E LETRAVE DHE E DITARIT TË JUSUF GËRVALLËS

1. ILIADA
2. ODISEJA
3. SKENDERI I KROJEVE TË KRUJËS
4. "HUMBJA" DHE GJETJA E PJESËS SË TRETË

1. ILIADA

Është shumë me rëndësi dhe e domosdoshme të tregohet e vërteta për letrat origjinale të Jusuf Gërvallës, ndër to edhe Raporti i korrikut 1981 dërguar Degës së LNÇKVSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, si dokumente burimore kryesore të veprimtarisë së Jusufit. Letrat origjinale të Jusufit dërguar Sabri Novosellës i ka bartur me vete Sabriu pas largimit nga Turqia, i cili, duke mos pasur vendbanim stabil në Zvicër dhe në Evropë, ato ia ka lënë për t'i ruajtur veprimtarit Haxhi Berisha, i lindur në Prapaqan të Deçanit, asokohe, me banim të përkohshëm në Arbon (TG) të Zvicrës. Vlen të theksohet se këto letra origjinale të Jusuf Gërvallës, në vitin 1987, Haxhi Berisha ia ka ofruar si material të dorës së parë publicistit Kadri Rexha, kohë kur ai e shkruan librin *Fati i luleve*.

Kur Haxhi Berisha u detyrua të largohet nga Zvicra dhe të kërkojë azil në Suedi, bibliotekën, së bashku me letrat e Jusufit dërguar Sabriut, si dhe gjëra të tjera personale i ka lënë te Demë Mustafaj me banim në Sulgen (TG), Zvicër. Pasi Haxhi Berisha stabilizohet në Suedi, me leje të përhershme të qëndrimit e me banesë, Demë Mustafaj ia kthen Haxhiut të gjitha letrat origjinale të Jusufit për Sabri Novosellën. Në ndërkohë, e di se Haxhiu ka pasur kontakte shoqërore me Sabri Novosellën.

Pra, kjo është rruga e <u>shtatë letrave</u> origjinale të Jusufit, kopja e parë, dërguar Sabri Novosellës në Turqi, nga 14 prilli 1981 deri më 14 janar 1982.

Ky libër "Shokët dhe Jusuf Gërvalla" për herë të parë u botua në shkurt 2013. Në shkurt 2013 për mua kanë qenë të njohura vetëm shtatë letra të Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës në Turqi. Katër letra: të 21 e 31 korrikut dhe 14 e 16 nëntorit 1981 më janë bërë të njohura më 31 gusht 2013 nga Kadri Rexha. Kjo është arsyeja pse në shkurt 2013 e kam përdorë fjalinë "*Pra, kjo është rruga e <u>shtatë letrave</u> origjinale të Jusufit, kopja e parë, dërguar Sabri Novosellës në Turqi, nga 14 prilli 1981 deri më 14 janar 1982*"

Fakti se këto katër letra kanë qenë të panohura për mua para 31 gushtit 2013, nuk i bën ato më pak interesante, më pak aktuale dhe më pak të vërteta.

Shprehja e vërtetë dhe më komplete duhet të jetë: Pra, kjo është rruga e njëmbëdhjetë (11) letrave origjinale të Jusufit, kopja e parë, dërguar Sabri Novosellës në Turqi, nga 14 prilli 1981 deri më 14 janar 1982

Çka do të thotë fjala origjinë?

Origjinë do të thotë fillimi i diçkaje, burimi, prejardhja, lindja dhe formimi i diçkaje, zanafilla.

Çka do të thonë fjalët origjinal, - origjinale, -origjinalet?

Dorëshkrimi i parë i një vepre a dokumenti; vepër e vërtetë e krijuar nga dikush, që nuk është përkthim, riprodhim ose kopje e një tjetre; vepër ashtu siç është krijuar për herë të parë dhe që nuk ka pësuar asnjë ndryshim të mëvonshëm, që është bërë nga vetë autori.

Letrat *origjinale* të Jusufit të krijuara në dy ekzemplarë nga Jusufi dërguar të tjerëve dhe Sabri Novosellës janë bërë pra nga i njejti person, në të njejtin vend dhe në të njejtën kohë.

Në kuptimin teknik, fleta e parë që është goditur nga tangentet metalike të germave të makinës së shkrimit quhet *origjinal*, ndërsa fleta e dytë që vendoset pas letrës së indigos *kopje.* Teknikisht ato mund të dallohen vetëm përnga cilësia. Cilësia teknike e fletës së parë që është goditur nga tangentat metalike të makinës mund të jetë më e mirë. Kjo pra sa i përket aspektit teknik. Përveç aspektit teknik e kemi atë juridik. Pse Jusufi (kjo metodë pune nuk është zbulim i Jusufit) i krijon dy ekzemplarë të njëkohshëm të letrave të tij. Ai e bënë këtë sepse është i vetedijshëm se është në luftë, se letrat e tij, nga pakujdesia mund të humbin; nga interesi mund të keqpërdoren apo lihen në heshtje; nga ndonjë aksion i UDB-së munden me ra në dorë të UDB-së dhe mund të falsifikohen apo të kontestohen nga UDB-ja. Për këtë arsye e mban për vete ekzemplarin e dytë, nën kontrollin e tij në shtëpinë e tij, që në aspektin teknik quhet *kopje*, por që juridikisht është shumë më i fuqishëm e më vendimtar se ekzemplari i parë që teknikisht quhet *origjinal* që del nga shtëpia e tij dhe merr rrugët e botës.

Origjinalin e letrës (kopjen e parë) Jusufi vazhdimisht ia ka dërguar Sabri Novosellës, ndërsa kopjen e dytë të origjinalit Jusufi e ka ndalë, si dëshmi, për vete. Odiesejada e kopjes së dytë e këtyre letrave ka një fat e rrugë krejtësisht tjetër nga ai i pari.

2. ODISEJA

Më 18 janar 1982, policia gjermane, për nevojat e zhvillimit të hetimeve i merr nga studioja e Jusufit, pos tjerash, të gjitha letrat që kanë të bëjnë me aktivitetin e tij politik. Pra, policia merr ekzemplarin e dytë origjinal të të gjitha letrave të Jusufit, në këtë rast jo vetëm ato dërguar Sabri Novosellës, por edhe letrat tjera, si ato për Kadri Zekën dhe Ibrahim Kelmendin. Më 28 mars 1982, gruaja e Jusufit me fëmijët, përmes Vjenës, shpërngulen në Shqipëri. Gjatë këtij udhëtimi familja e Jusufit nuk i merr letrat që kanë të bëjnë me veprën politike të Jusufit.

Xhafer Durmishi: "*Në policitë e Gjermanisë dhe të Zvicrës vazhdojnë të qëndrojnë dokumentet e marra pas atentatit, të cilat flasin për punën e tyre dhe bashkëpunimin e tyre (në mes Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës - shën im) njëvjeçar."* (Zëri i Kosovës, Stockholm, janar 1985)

Për qëndrimin e tij në Shqipëri në verën e vitit 1985 dhe kthimin prej andej, kështu shkruan

Faridin Tafallari: "*Më 31 gusht (1985-shën i Xh. D.) paradite erdhën Sulejmani dhe Petriti; do të rrimë ca çaste me ta se pasdite do të nisem për në Gjermani. Do të vijë edhe Suzana, e shoqja e Jusufit. Për në aeroportin na përcjell Fiqiriu, Papi, Premtoni, Donika dhe Ergoni e ca të tjerë. U përshëndeta me Fiqiriun, Ergonin e të tjerët dhe hipëm në aeroplan. Zbritëm në aeroportin e Vjenës; bënte ftohtë. ... Me makinën e ambasadës shkuam në ambasadë; porsa i lam teshat, shokët Petrit dhe Ylli na çuan në një hotel larg qytetit për të ngrënë darkë dhe pas një pushimi u kthyem përsëri, morëm biletat për Gjermani. Me ne ishte edhe Shabani që udhëtonte për në Mynih; ky merrej me tregti. Në kufirin Austri-Gjermani na u afrua doganieri për punën e vet dhe po na shikonte pasaportat. Ishte për t'u habitur: ne ishim që të tre nga Kosova, por kishim pasaporta të ndryshme: unë pasaportë të Jugosllavisë, Shabani të Turqisë, kurse Suzana kishte pasaportë shqiptare. Doganierit i treguam se si ishte puna dhe ai u çudit.* ***Suzana vinte në Gjermani për të marrë teshat e Jusufit dhe të kunatit (Bardhoshit), si dhe për disa punë tjera që kishin të bëjnë me policinë gjermane."*** (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 94-95)

Kur gruaja e Jusufit, Suzana vjen nga Shqipëria, për shumë punë që kanë pasë të bëjnë me policinë gjermane, ajo shkon në polici së bashku me Faridin Tafallarin për të marrë shumë gjëra, pos tjerash edhe letrat politike të Jusufit. Në këtë rast, Suzana e Faridini, pa e ditur odisejadën e origjinalit të parë (ekzemplarit të parë) të letrave të Jusufit për Sabri Novosellën, mirren vesh se është e rëndësishme që një ekzemplar i tyre të gjendet në duart e sigurta të Faridin Tafallarit, pasi jetës e peripetive të saj nuk i dihet. Faridin Tafallarit me këtë rast i jepet mundësia që përveç letrave të Jusufit dërguar Sabri Novosellës, t'i ruaj edhe letrat dërguar Ibrahim Kelmendit, Kadri Zekës, Enver Hoxhës, etj.

Gjatë punës time për analizimin e veprimtarisë së Jusufit dhe Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, jam bazuar në letrat e Jusufit të cilat janë publikuar në librat e Faridin Tafallarit.

3. SKENDERI I KROJEVE TË KRUJËS

1. Letrat do të botohen sepse janë në duar të sigurta
2. UNION POSTALE UNIVERSELLE
3. Uroj të mos ketë falsifikime
4. Uroj të ketë falsifikime
5. Uroj të angazhohet Kadri Rexha
6. Donika do t'i bënte nder babait të saj
7. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarin, 7 tetor 2013
8. TI IA KE BESUAR ARKIVIN E JUSUFIT MIKUT TONË TË PËRBASHKËT
9. S'MUND TË HELMOJNË

1. Letrat do të botohen sepse janë në duar të sigurta

Faridin Tafallari: "*Ibrahim a të kujtohet kur më the, për librin tim, se me këto "sekrete"(?), që i ke shkruar mund të hash dhe plumbin!?! Por ja, për fat të keq të dikujt ende jam gjallë dhe kam shumë e shumë për të shkruar e dëshmuar..., kam edhe shumë*

letra nga Jusufi i Madh, të cilat bashkëveprimtarja dhe bashkëshortja e tij, e nderuara dhe shumë e respektuara Suzana Gërvalla, m'i la mua !!!... Dhe unë do t'i qëndroj BESNIK asaj dhe amanetit të bashkëshortit të saj, trimit, JUSUFIT të MADH...dhe të gjitha LETRAT do të botohen... jam apo nuk jam unë, sepse janë në duar të sigurta…!!! Për mua, pasuria më e madhe e imja janë letrat e Jusufit, ashtu siç është fati im i madh, dhurata më me vlerë e jetës, vitet që kalova pranë Trimave, vitet me JUSUFIN e MADH dhe në fund nderi akoma më i madh nga familja Gërvalla, të cilën ma bëri Suzana, duke ma besuar mua këtë pasuri…!" (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiran 2010, faqe 306-307)

Ibrahim Kelmendi: "*Po të ishte në dorën time, asnjëherë nuk do t'i publikoja letrat e raportimet që Jusufi ia ka dërguar Sabri Novosellës në Turqi.*" (FBook tetor 2017)

Ibrahim Kelmendi: "*Kjo lloj "bredhjeje" e "letrave" dhe "raportit", dërguar udhëheqësit të tij SN, tani që i lexova për herë të parë më irrituan dhe shqetësuan veçmas."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

2. UNION POSTALE UNIVERSELLE – UNIVERSAL POSTAL UNION (UPU)

Shoqata Postale Botërore është një bashkim i 197 vendeve anëtare, dhe qëllimi i saj kryesor është që bëjë të mundshme shkëmbimin ndërkombëtar të postës. UPU është themeluar më 9 tetor 1874 nga Heinrich von Stephan dhe e ka selinë në Bern të Zvicrës. UPU është organ brenda Komeve të Bashkuara (OKB).

Në UPU është antare edhe Serbia me UDB-në dhe Tanjugun e vetë. Përderisa UDB-ja dhe Tanjugu nuk shqetësohen dhe irritohen për bredhjet dhe numrin e kilometrave nëpër të cilat duhet të kalojnë sipas nevojës mesazhet e tyre, atëherë si duhet ta kuptojmë irritimin e shqetësimin e Ibrahim Kelmendit?

Edhe Ibrahim Kelmendi në ngjashmëri me UDB-në dhe Tanjugun, nuk është i irrituar e shqetësuar për numrin e kilometrave të cilin e kanë kaluar letrat e Jusuf Gërvallës të dërguara Sabri Novosellës, por është i irrituar dhe shqetësuar për numrin e dëshmitarëve të gjallë të cilët i kanë lexuar letrat e Jusuf Gërvallës dhe Raportin e korrikut 1981, 20 vjet para botimit të romanit të I. K. "Atentatet" e të cilët janë: Sabri Novosella, Haxhi Berisha, Demë Mustafaj dhe Kadri Rexha.

3. Uroj të mos ketë falsifikime

Ibrahim Kelmendi: *"Uroj që në këtë "përmbledhje" të mos jetë amputuar apo mballosur ndonjë "letër" ose "raport" i falsifikuar, sikur gjoja është shkruar nga Jusuf Gërvalla!* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

4. Uroj të ketë falsifikime

Ibrahim Kelmendi: "*Uroj të kenë ndodhur falsifikimet, meqë më shumë dëshiroj të përflitem e denigrohem unë, bazuar në këso falsifikimesh, se sa të pësoj zhgënjim tronditës nga pandershmëria e Jusufit!"* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Ibrahim Kelmendi: "*Mënyra se si e paraqet Xhaferi "bredhjen" e atyre letrave dhe të "raportit", duke e ripërsëritur përcaktorin "origjinale", ma përforcon dyshimin se ai vetë do të ketë bërë falsifikime, ose ka njohuri për falsifikimin nga ndonjë usta tjetër.*

Pastaj është shpërdorur F. Tafallari si publikues i parë të cilit, si punëtor, do t'i besohej se nuk ka ditur të falsifikojë." (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Ibrahim Kelmendi: "*Vlerën e tij prej heroit nuk do t'ia ulin as këto shkresurina të falsifikuar, të "legalizuara" si të vërteta përmes karagjozit Faridin Tafallari*." (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Ibrahim Kelmendi: "*Meqë Xhaferi e ka marrë në shënjestër romanin tim "Atentatet", duhet të jetë angazhuar për të sajuar "raport", që i ndryshon ngjarjet nga paraqitja në roman, për të më denigruar me çdo kusht si dezinformues dhe si të armiqësuar me Jusufin."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Sabri Novosella: *"Faridin! Librin e kam marrë dhe e kam lexuar. Nuk kam ditur se do ta nxjerrësh. Aty janë pikërisht ato gjëra ashtu si kanë qenë. Nuk ka gjëra të shtuara dhe as të ndryshuara. Kishe botuar edhe letrat e Jusufit, letra që kemi komunikuar unë me Jusufin. Mirë ke bërë, se duhen botuar që të gjitha letrat që ka shkruar Jusufi. Është mirë të dimë gjithçka të tij."* (Letër Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 382)

5. Uroj të angazhohet Kadri Rexha

Ibrahim Kelmendi: "*Uroj të angazhohet edhe Kadri Rexha, meqë një pjesë të këtyre letrave, "kopjen e parë", i paskësh pasur në dispozicion që në vitin 1987 (ia paskësh dhënë Haxhi Berisha)!* ***Kadriu them se është në gjendje të vërtetojë autenticitetin e letrave*** *edhe në bazë të stilit, meqë është njohës i mirë i frazës dhe frymës së Jusufit."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Ibrahim Kelmendi: *"Pershendetje.*

Uroj te jeni sa me mire. Lexova keto dite libra te Xhafer Durmishit. Ja nje fragment:

Xhafer Durmishi: "Është shumë me rëndësi dhe e domosdoshme të tregohet e vërteta për letrat origjinale të Jusuf Gërvallës, ndër to edhe Raporti i korrikut 1981 dërguar Degës së LNÇKVSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, si dokumente burimore kryesore të veprimtarisë së Jusufit. Letrat origjinale të Jusufit dërguar Sabri Novosellës i ka bartur me vete Sabriu pas largimit nga Turqia, i cili, duke mos pasur vendbanim stabil në Zvicër dhe në Evropë, ato ia ka lënë për t'i ruajtur veprimtarit Haxhi Berisha, i lindur në Prapaqan të Deçanit, asokohe, me banim të përkohshëm në Arbon (TG) të Zvicrës. Vlen të theksohet se këto letra origjinale të Jusuf Gërvallës, në vitin 1987, Haxhi Berisha ia ka ofruar si material të dorës së parë publicistit Kadri Rexha, kohë kur ai e shkruan librin Fati i luleve."

(https://de.scribd.com/doc/196144081/Shoket-dhe-Jusuf-Gervalla; f. 13)

Deshirova te di, eshte korrekt Xhaferi me kete informim?

Te falenderoj per mirekuptim.

Me respekt, I. Kelmendi" (Letër Kadri Rexhës, 31 tetor 2014)

Kadri Rexha: "*Përshëndetje!*

Uroj të jeni mirë në çdo aspekt!

Letrat origjinale të Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës i kam lexuar në Arbon (CH), në banesë të Haxhi Berishës, në gusht të vitit 1986. Gjatë shkrimit të librit

tim "Fati i luleve", në vitin 1987-1988, këto letra i kam shfrytëzuar si material të vetëm origjinal lidhur me veprimtarinë e Jusufit në mërgim. Pra, pjesa e librit tim "Fati i luleve" që trajton veprimtarinë e Jusuf Gërvallës në mërgim, është e shkruar duke u mbështetur në letrat dhe Raportin e korrikut 1981... të Jusufit dërguar Sabri Novosellës si dhe në gazetat atdhetare "Bashkimi", "Lajmëtari i lirisë", Liria" dhe "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ. Këto të dhëna mund të dëshmohen lehtë me një lexim të kujdesshëm të librit "Fati i luleve".

Kjo dëshmi imja përputhet edhe me fragmentin e mësipërm të Xhafer Durmishit.
Gjithë të mirat!
Me respekt, K. Rexha" (Letër-përgjigje Ibrahim Kelmendit, 31 tetor 2014)

Ibrahim Kelmendi: *Te falenderoj per kete informim*. (Pra e falenderon Kadri Rexhën që i është përgjigjur letrës së tij-shën i Xh. D.)

6. Donika do t'i bënte nder babait të saj

Ibrahim Kelmendi: "*Zonja Donikë Gërvalla-Schwarz ka marrë përsipër t'i dalë zot trashëgimisë të babait të saj. Sigurisht që do t'i bënte nder babait nëse do të hulumtonte autenticitetin e letrave që i kanë publikuar Faridin Tafallari dhe Xhafer Durmishi, duke i krahasuar me kopjet që duhet t'i ketë ruajtur hetuesia gjermane."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Shaban Muharremi: "*Donikë e nderuar, unë ju thash se kam lexuar shumë në lidhje me Jusufin. Nëse keni mundësinë të me njoftoni për një gjë u jam shumë mirënjohës - nuk jeni e obliguar, por jam shumë kurreshtar t'a ndëgjoj nga ju. A është e vërtetë që shtat (7) letrat e Jusufit (publikuar nga F. Tafallari dhe analizuar nga Xh. Durmishi) dërguar S. Novosellës dhe Ibrahim Kelmendit janë origjinale. Kalofsh mirë. Shabani* (Letër Donika Gërvallës, 16 maj 2013)

Donika Gërvalla: "*Sa i përket letrave të përmendura çështja është mjaft e komplikuar. Deri sot asnjëherë nuk jam marrë publikisht me këtë çështje dhe duke pasur parasysh që është Xhaferi në këtë mes, nuk besoj ta bëj as në të ardhmen. Dokumentet që i ka botuar F. Tafallari në librin e tij kanë një gjenezë të çudishtme. Në vitet 1984-1985 Mami pati ardhur nga Shqipëria në Gjermani për të tërhequr në prokurori dokumentet e Babit, të cilat nuk nevojiteshin me gjatë procesit hetimor, pasi që ishin fotokopjuar apo konsideruar si të pavlefshme për hetimin e vrasjes. Për të mos i marrë me vete në Shqipëri, Mami ia beson F. Tafallarit për t'i ruajtur deri sa të ketë mundësi Mami t'i tërheqë. Radha i erdhi F. Tafallarit sepse ishte ndër të vetmit që në atë kohë kishte me vete familjen e tij dhe banim stabil. Xhaferi, Hafizi, Naimi, Haxhiu dhe plot të tjerë që i kishte mbajtur Babi afër vetes, ose nuk ishin më në Gjermani, ose banonin herë këtu e herë aty. Pas demokratizimit të Shqipërisë, megjithë kërkesat e përsëritura, F. Tafallari jo vetëm që nuk i ktheu dokumentet asnjëherë, por madje i keqpërdori duke i botuar.*
E zgjata. Shumë të fala nga unë." (Letër Shaban Muharremit, 3 qershor 2013)

7. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarin, 7 tetor 2013

Mirëdita

Isha sot këtu për të marrë dokumentet e Babait, mirëpo nuk ju gjeta në shtëpi. Ju lutem më`i dërgoni dokumentet në adresën time:

Donika Gërvalla, Ungartenstr. 9, 53229 Bonn

Shpenzimet e transportit kuptohet që i marr përsipër unë. Aty ka dokumente që janë pjesë e dosjes hetimore rreth vrasjes, prandaj ju lus që për të mos rrezikuar apo ngadalësuar këto hetime të më dërgoni të gjitha dokumentet dhe as të mos botoni diku ndonjë pjesë të tyre dhe as mos t`ia tregoni më askujt. Ato dokumente janë pronë e familjes Gërvalla, dhe i duhen kthyar asaj. Unë erdha miqësisht për te marrë dokumentet dhe për të shkëmbyar dy fjalë. Ju lutem më dërgoni dokumentet brenda 10 ditëve të ardhshme.

Shumë të fala edhe familjes. Donika Gërvalla (nënshkrimi)

P.S. Shënimi i F.T.) Letër e lën në kutin e postës në adresën time pa emrin e pranuesit (timin) në Horberstr.37, 72221 Haiterbach, dhe pa zarfe, në dy letra A5 e shkruar në dorëshkrim, pa datë!? Këtë letër e mora në mëngjesin e të hënës me datë, 07.10.2013

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari, në përmbledhjen me titull: Letra, që më kanë dërguar Suzana dhe Donika Gërvalla, www.albaniapress.com, 8 nëntor 2013)

8. TI IA KE BESUAR ARKIVIN E JUSUFIT MIKUT TONË TË PËRBASHKËT

Ibrahim Kelmendi: ”*Po e potencoj edhe njëherë: ke pas mundësinë ta zhdukje, që të mos e kishte mundësinë as* ***Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante.***” (Letër pblike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

9. S’MUND TË HELMOJNË

KROI

Të kanë parë ëndërr njerëzit e planetit tjetër
ty që bënë dashuri të fshehtë me natën e përlotur
si njeriu i frikësuar. Gjëmon si njeriu.
Ia ke ftohur shalqirin plakut një ditë vere
ia ke parë gjinjtë Trëndelinës.
S'kanë ardhur te ti të pinë por t'i shohin vashat.
Nuk je ngrirë në dimër.
S'ke shteruar verës.
Fije e hidhur e kujtimit të fëmijërisë.

Në ty kam larë duar e faqe.

Të kanë parë ëndërr njerëzit e planetit tjetër,
je një hero vere kur shterojnë puset.
Të duan zogj e të dehur.
Kurrë s'ke fluturuar në vendet e Jugut.

Buzë teje është gjunjëzuar trimi plagët i ka larë.
Thonë: Të ndeshemi te kroi.
Ditëve të hershme të marsit na i lagë këpucë e çorapë.
Vjeshtës nuk të zverdhin gjithë gjethet e rëna.
Je vetullngrysur.
Hyjnitë të kanë gjetur në një guacë oqeani
e të kanë sjellë këtu në zemër të fshatit
- arterien ta kanë lidhur me bjeshkën
e s'i ke frikë tërmetit.

Ti më së shumti ke dëgjuar përralla për etjen.
Ua di të vërtetën shekujve po s'ke gjuhë të thuash
S'mund të helmojnë.
Natën pinë ujë në ty drenushat.
Askënd nuk e pret
as ushtarin - hasretin e nënës.

Anës sate prehet në flladin e verës
bilbili i Mjedës.
Gjatë tërë erës të zbukurojnë lulet.
Të vijnë njerëz e bletë.
Të ndihet gurgullima edhe kur fashiten tokë e qiell
kur s'ndihet frymëmarrja e kafshëve.
Kur digjet ndonjë kullë e lartë
të pinë trarët e shkrumbuar.

Ka mbetur në ballin tënd të gdhendur
dor' e mjeshtrit desariot
- e myshku ka folur me gjuhë të lagështisë
së përmotshme. Asnjëherë s'ke lënguar nga trauma
- asnjëherë s'je dehur.
Pa ty në bjeshkë për ujë do të na shkonin vashat
e do të hutoheshin pas mëzatit të verës
të djegura në krah ato do të ktheheshin
si fluturat në vapë
e do të dënesnin me ngashërim.

(Jusuf Gërvalla, Kroi, Vepra 1, Prishtinë 2010, faqe 121-122)

4. "HUMBJA" DHE GJETJA E PJESËS SË TRETË

Në fillim të tetorit 1995 isha në Hamburg. Aty pata rastin ta takoj Donika Gërvallën. Gjatë bisedimeve e solli bisedën dhe u ankua për "humbjen" e Ditarit të Jusufit. Ajo me atë rast më pat pyetur edhe për atë se a e kam lexuar, apo a ma ka dhënë Jusufi për ta lexuar përmbajtjen e Ditarit. Me atë rast, Donika patë thënë se Ditari na ka humbur në duart e policisë, pra nuk na është kthyer nga policia. Pasi më pyeti, unë shkurtimisht ia pata thënë disa fjalë për Jusufin dhe rrethin e tij, por asaj nuk i bënë aspak përshtypje fjalët e mia.

Më 5 dhe 6 mars 2012, i pata dy biseda me Faridin Tafallarin, lidhur me një thirrje telefonike të Donika Gërvallës. Faridini më tregoi se e ka thirrë Donika në telefon dhe

paska biseduar me te rreth një orë. Donika i paska treguar se është duke zhvilluar një proces gjyqësor, se i nevojitet ndihma e disa vetave, dhe disa rrena të tjera pa fijen e krypës.

Donika i thotë Faridinit, se Dosja policore i ka rreth 2500 faqe, dhe shton se do t'ia dërgoj rreth 200 faqe material të hetimeve përmes e-mailit, edhe pse Faridini nuk i kërkon asgjë.

Por meraku i saj vendimtar, sipas Faridinit, paska qenë se mos e posedon Faridini një kopje komplete të Ditarit të Jusufit, nën arsyetimin e Donikës se gjoja ai Ditar paska humb në polici, se policia gjermane, kur i ka marrë shumë materiale më 18 janar 1982 nga studioja e Jusufit, të gjitha më vonë i janë kthyer familjes, me përjashtim të Ditarit, i cili nuk iu paska kthyer familjes, pasi paska humbur në duart e policisë. "Me heqjen e merakut rreth Ditarit", Donika nuk i lajmërohet më.

Faridini i posedon të gjitha vërtetimet origjinale të policisë gjermane, që përmbajnë të gjitha listat e gjërave që janë marrë nga policia dhe që i janë kthyer nga policia familjes së Jusufit.

Sa i përket çështje së Ditarit, vërtetimi i policisë e ka këtë përmbajtje:

Landespolizeidirektion Stuttgart I
Kriminalpolizei - Untergruppenbach den 18-1-1982
(Policia për hetimin e krimeve –Untergruppenbach më 18 janar 1982)

Zimer (dhoma) 5 **Blatt (**fleta**) 2**
Lfd. Nr. 5. 19 2 1 Tagebuch , (Ditar) **1 Bild** (fotografi) ***Baier***
Unterschrift (nënshkrimi)
(Name und Amtsbezeichnung)
(Emri dhe titulli)
Baier / SICK

Në mesin e dokumenteve të kthyera është edhe Ditari.

Ditari i Jusufit nuk ka humb për asnjë çast.

KUSH JANË ATA?

1. I rrënjosur thellë deri nëpër familje
2. Regjimi komunist
3. Ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore
4. Kush janë ata
5. Përpiqen të fitojnë kapital politik
6. Ju lutemi, na dërgoni materialet tuaja!
7. Amaneti dhe porosia
8. Për mua dhe vëllezërit e mi
9. Për nënën tonë
10. Për nënën Ajshe
11. Për shumë njerëz në Kosovë
12. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"

1. I rrënjosur thellë deri nëpër familje

"Jusuf Gërvalla ishte gazetar, shkrimtar, veprimtar politik, këngëtar dhe publicist. Tek popullata shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj ai është i rrënjosur thellë deri nëpër familje. Popullariteti i tij fillimisht bazohej në prezantimet e tij si këngëtar në radio dhe televizion, si gazetar në "Rilindje" si dhe më pas edhe në jehonën e veprimtarisë së tij politike dhe patriotike në Kosovë dhe Gjermani." (www.gervalla.org, 2007-2009)

Kujtimi i Jusuf Gërvallës është i rrënjosur në familje dhe në individ. Rrënjosja e kujtimit, më e fuqishmja bëhet në baza individuale pasi secili njeri e konsideron veten pronar të trurit të vet. Ndoshta fjalët *ai është i rrënjosur thellë deri nëpër familje* përveç informatës shtrojnë edhe kërkesën: Në ato familje ku është rrënjosur kujtimi i Jusuf Gërvallës, duhet para së gjithash të rrënjoset kujtimi i familjes.

2. Regjimi komunist

*"Shtypja e vazhdueshme e popullatës në Kosovë nga ana e regjimit **komunist** jugosllav, nga artisti dhe gazetari Jusuf Gërvalla, bëri edhe veprimtarin politik Jusuf Gërvalla."* (www.gervalla.org, 2007-2009)

Jusuf Gërvalla nuk e ka konsideruar kurrë në epokën e tij regjimin jugosllav si regjim komunist. Ideologjikisht, Jusufi e ka konsideruar veten, dhe ka qenë komunist, marksist. Fjalët e mësipërme janë padituri dhe përpjekje për falsifikim të luftës së Jusufit dhe shokëve të tij të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, sidomos të atyre që i ka pasur në Shtutgart. Përpjekjet e tilla janë të dënuara me dështim.

3. Ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore

"*Ai merr pjesë në lëvizjen ilegale, e cila ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore që vuanin nga regjimet e tyre diktatoriale përpiqej të mbronte dhe të realizonte të drejtat e popullatës ndaj shtypjes totalitare të regjimeve përkatëse*." (www.gervalla.org, 2007-2009)

Lufta e drejtuar nga Jusufi (në Gjermani) dhe shokët e tij nuk është imituar prej vendeve të Evropës Lindore. Asnjë rresht, në revistat e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇKVSHJ) nuk e vërteton këtë.

4. Kush janë ata

Sabri Hamiti: "(DONA - Donika Gërvalla)
Kush janë ata t'u flas për babain tim.
Asnjë fjalë.
Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë.
Duhet të kthehem atje për ta rinjohur.
Jashtë nuk ka qenë i njëjti. ....
Interesi i humbur për gitarën e vetë, për flautën time.
Atëherë s'kam ditur gjë, tash e di si ia hëngrën shpirtin paknapak përditë.
Ai për mua kishte humbur në Gjermani.
Bishat ia hëngrën zemrën.
Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij.
Jo.
Nuk lejoj, nuk dua.
Çka kanë bërë për të, asgjë.

E kanë veshur vdekjen e tij me një vel të mjegullës, me peshën e territ.
Jo!
Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe." (Misioni, Prishtinë 2007, f. 88-89)

5. Përpiqen të fitojnë kapital politik

Donika Gërvalla: *"Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik."* (17 janar 2010, http://gervallablog.com)

6. Ju lutemi, na dërgoni materialet tuaja!

mejusufin

DEVRE DYNJA!
Sabri Hamiti: "(DONA - Donika Gërvalla) *Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe."* (Misioni, Prishtinë 2007, f. 88-89)

"Një nismë për të mbledhur dhe publikuar kujtimet tuaja me Jusuf Gërvallën

A e keni takuar ndonjëherë Jusuf Gërvallën?
A njihni dikë që e ka njohur?
A njihni dikë që mund të ketë ende shkrime, fotografi apo këngë të Jusufit (kaseta, pllaka, video)? Ju lutemi, na lejoni të bëjmë një kopje profesionale të tyre.
A ju kujtohet ndonjë këngë, tekst apo ngjarje para dhe pas vdekjes së tij, që ju ka lënë mbresë dhe ka domethënie të posaçme për Ju?
Na shkruani nëse Jusufi ju ka frymëzuar për një vepër atdhetare, letrare, artistike apo thjesht njerëzore në ndonjë fazë të jetës suaj. (Frymëzimet nga burime tjera, që kanë ndikuar apo kanë qenë bazë për njohjen me te nuk i bëhen kabull askujt.)
Ju lutemi, na dërgoni materialet tuaja! (Ç'është ky vrap i mjerë?!)
Fondacioni Gërvalla me anë të këtyre dëshmive dëshiron të paraqesë sa më realisht figurën e Jusuf Gërvallës. (Sepse vepra e shkruar me dorën e tij nuk mjafton, nuk është reale, pasi ai në Gjermani nuk ka qenë i njejti si në Kosovë, ka qenë i manipuluar.)
Vullneti juaj do të respektohet, nëse dëshironi që dëshmia Juaj të mbetet konfidenciale.
(Nëse Ju na e garantoni përjetësinë, ne u garantojmë se emrat tuaj, si shokë të Babit, do të zhduken përjetësisht, në mënyrë konfidenciale, dhe ajo çka mbetet do të jetë vetëm Babi, Mami dhe fëmijët.)
Publikimet mund të bëhen vetëm me pëlqimin tuaj.
(Turp për ata që kanë shkruar për luftën e vetë së bashku me Babin pa pëlqimin tonë.)
Ju lutemi, ndihmoni të dokumentojmë trashëgiminë e Jusufit për brezat e ardhshëm. Mbështesni nismën „Me Jusufin". (www.gervalla.org, janar 2012)

Sabri Hamiti: "(DONA - Donika Gërvalla) *Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe."* (Misioni, Prishtinë 2007, f. 88-89)
DEVRE DYNJA!

7. Amaneti dhe porosia

Më 18 janar 2012, (e mërkurë), në akademinë përkujtimore në Prishtinë, në patronazhin e kryeministrit Hashim Thaçi.

"*Në emër të familjes Gërvalla, një fjalë rasti e mbajti edhe e bija e Jusuf Gërvallës Donika, e cila me këtë rast ka theksuar se dëshiron të përcjell të dy amanetet e të atit: "Dy porosi dërgon babai im me këtë rast. E para, që këta të tre dëshmojnë qartë se sa mendime të ndryshme mund të kesh dhe përsëri kur është çështja për një ideal të përbashkët të ulesh në një tavolinë, të bisedosh dhe të gjesh zgjidhje. Porosia e dytë e babait tim në ditën e sotme që ideali i tij, amaneti i tij, është që Kosova të jetë e lirë, të jetë demokratike, të jetë një Kosovë në të cilën banorët e saj të jetojnë jetën e tyre me dëshirë dhe aspiratat e tyre t'i realizojnë" ka thënë Donika Gërvalla*." (Bota Sot, 19 janar 2012, faqe 6)

Amaneti dhe porosia e Jusufit qëndron e gjallë në fjalët e shkruara në revistat e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe organizatave tjera. Vepra e Jusufit iu jep mundësi të gjithëve që dinë shkrim e lexim të gjykojnë në mënyrë të pavarur, pa tutelën e diktatin e askujt. Ajo i jep mundësi secilit që është i interesuar dhe kërkon ndihmë nga ajo vepër të bëjë interpretimet e veta. Fjalët *Dy porosi dërgon babai im me këtë rast* tregojnë joseriozitet.

8. Për mua dhe vëllezërit e mi

Donika Gërvalla: *"Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë."*

Kjo është e drejt e juaja që nuk ka fuqi në botë që mund t'ua mohoj apo ndryshoj, dhe as që është munduar ndokush me ua mohuar. Por këto fjalë nuk janë vetëm një konstatim. Këto mund të kuptohen edhe si porosi: Të gjithë ata që duan ta kujtojnë Babin, e kanë të pamundur ta kujtojnë si "Babi" pa i pasur në imagjinatën e tyre edhe "*mua dhe vëllezërit e mi".*

Fakti është fakt, por fakti i përmendur nuk është shkak. Aspektin prindor të Jusuf Gërvallës askush nuk e ka nënçmuar. Por shteti serbomadh e ka vra pse ka qenë luftëtar i lirisë dhe jo pse ka qenë prind i tre fëmijëve.

9. Për nënën tonë

D. G.: "*Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës*."

Komenti në pikën e mësipërme mund të aplikohet edhe në këtë rast.

10. Për nënën Ajshe

D. G.: "*Për Nënën Ajshe, së bashku me mixhën Bardhosh, ata mbesin djemtë e saj të dashur, vdekja e të cilëve ia rëndoi zemrën shumë.*"

Përderisa në dy pikat e mësipërme kemi me persona të gjallë, ku bija, bijtë apo gruaja, me ndonjë vepër në të ardhmen mund t'ia kalojnë babait apo burrit, dhe ta lënë atë nën hijen e tyre, në rastin e Nënës së Vëllezërve Gërvalla kemi me një proces që është mbyllur dhe nuk ndryshon më. Ajshe Gërvalla njihet dhe do të njihet, vetëm si Nëna e Jusufit dhe Bardhoshit në radhë të parë, dhe jo e kundërta. Jusufi dhe Bardhoshi nuk janë vra dhe nuk kujtohen **për shkakun** se kanë qenë bij të Ajshe Gërvallës.

11. Për shumë njerëz në Kosovë

D. G.: "*Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta."*

Pse në këtë rast Donika Gërvalla-Schwarz, me banim në Gjermani, flet vetëm për shumë njerëz në Kosovë dhe për asnjë të vetëm në Gjermani e në mërgim? Sepse:

Sabri Hamiti: "(DONA)
Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë.
Duhet të kthehem atje për ta rinjohur.
Jashtë nuk ka qenë i njëjti. ....
Ai për mua kishte humbur në Gjermani.
Bishat ia hëngrën zemrën.
Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij.
(Misioni, Prishtinë 2007, f. 88-89)

12. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"

Pal Sokoli: "Emocione zgjoj edhe akti kur unë (Pal Sokoli) në marrëveshje me kryetarin z. Martin Çuni dhe kryesinë e LSHAKSH-së në Gjermani shpalla vendimin për anëtarësimin, (post mortum) në Lidhjen e shkrimtarëve, artistëve dhe krijuesve shqiptarë në Gjermani, e dy figurave të ndritshme të kombit tonë; patriotin, poetin dhe artistin; Jusuf Gërvalla, si edhe albanologun, linguistin, shkrimtarin modern, dhe pedagogun e urtë prof. Martin Camaj. Salla e duartrokiti në duke qëndruar në këmbë disa minuta, këtë vendim të qëlluar. Në skenë e ftova z. Martin Çuni, që në emër të LSHAKSH-së në Gjermani, fletë anëtarësimin më emër të Jusuf Gërvallës të ja dorëzoi bijës së tij, Donikë Gërvalla- Schwarz. Donika e pranoi e emocionuar dhe tha:" Ju falënderoj përzemërsisht për këtë akt, dhe e besoj se po të ishte gjallë Jusufi, askund nuk do ta ndjente veten më mirë së në gjirin e kësaj Lidhje..". (LSHAKSH dhe SH.I.H.K nderuan trinomin Gërvalla dhe Zeka; www.zemrashqiptare.net, 6 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: *"Vehbi Ibrahimi, i vrarë në Belgjikë, ishte sekretari personal i (E. Kastriotit). Ky far Emili i së ashtuquajturës "Besëlidhja shqiptare", është një nga reaksionarët më të mykyr të shqiptarëve në Perëndim. Enver Hadri, për sa jam i informuar, i takon gjoja një partie komuniste, por me orientim prorus. Edhe Martin Camaj, për sa dimë, është kundër Shqipërisë. Për emrat e tjerë, adresat e të cilëve na janë dërguar me nganjë pikëpyetje pranë, nuk dimë gjë. Ne s'po u dërgojmë tash për tash asgjë, derisa të mos vërtetohet puna e tyre. Në qofshin si këta që përmendëm më lartë, s'kemi pse ua dërgojmë as "helmin", lëre më shtypin tonë. (Fjala është për Hasan Beun në Amerikë, Hysen Çamin në Suedi, Vincenzo Gollettin në Frankfurt)."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 454)

KAM PRETENDIME

QË NË KOSOVË KA ARDHUR KOHA TË MOS HESHTET – HESHTJA PËR TË CILËN KAM FOLUR NUK KA TË BËJË ME RRETHANAT E VRASJES

Këtu, në këtë kapitull, e kemi një lloj pokeri primitiv të Donikës. Në pikat 2-4 të këtij kapitulli, ajo krenohet sa s'ka më tepër për atë se ka heshtë. Brenda membranës së heshtjes, fshihet kërcënimi, bomba që do të eksplodojë. Ajo pret lavdata e duartrokitje për heshtjen e saj, të cilën vetëm ajo ka mundur ta përballoj dhe për këtë i kemi pasur të gjitha këto vite jete në paqe.

Në pikat 5-6 shprehen akuzat e helmi kundër atyre që kanë heshtur dhe me qëllim e kanë mbajtur vrasjen të pazbuluar e pasqaruar. Pika 7 është thirrje për aleancë, zhurmë, e poterë, që do ta zhdukë heshtjen.

Ajo çka dominon në pikat 2-7 është krejtësisht aspekti juridik, lufta për ta ndriçuar vrasjen e 17 janarit 1982. Thelbi i problematikës: Kartat e pokerit, faqet e dosjes, nuk kanë asnjë vlerë juridike (megjithëse mund të kenë vlerë historike) dhe nuk përmbajnë fakte të majftueshme për ta hedhur në gjyq askend, sipas standardeve të drejtësisë gjermane. Duket sikur Donika është e dëshpruar në drejtësinë gjermane dhe kërkon ndihmë prej drejtësisë dukagjinase. Për të gjitha këto aspekte ekskluzivisht juridike bëhet zhurmë në Kohën Ditore, më 19 janar 2012.

Më 18 maj 2012, në intervistën dhënë Agron Bajramit, Donika e pranon se kartat e saj të pokerit nuk kanë pasur vlerë dhe ngarkesë juridike. Qëllimi i saj, motivet e saj kanë qenë vetëm politike. Ajo thotë se këtë çështje e ka shtruar sepse ka **pretendime**. Prandaj, të gjithë ata njerëz, që e kanë plagë në zemër çështjen e vrasjes së 17 janarit 1982, mund ta ngushëllojnë veten, dhe mund ta fitojnë një lloj kompensimi vetëm nëse rreshtohen pas saj për t'i luftuar e përmbysur pushtetmbajtësit e korruptuar në Prishtinë, të cilët ia kanë pru shpirtin tek hunda popullit tonë. Kjo çështje shihet në pikat 8-12.

Donika Gërvalla: "Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik." (17 janar 2010, http://gervallablog.com)

1. Vrasësit nuk kanë pasur motive politike
2. Kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes
3. Kam heshtur rreth asaj që kam mësuar
4. Kam heshtur edhe prej moshës 10-18 vjeçare
5. Nuk duhet të heshtin dëshmitarët
6. Nuk duhet të heshtet as për atë burrë që e dërguan me armë tek Babi
7. Le ta thyejmë heshtjen së bashku…
8. Cila është ajo heshtje që duhet thyer?
9. Heshtja për të cilën kam folur nuk ka të bëjë me rrethanat e vrasjes
10. Kërcënimi i detyron këta njerëz të heshtin
11. Ka ardhur koha të mos heshtet
12. Kam pretendim që në Kosovë ka ardhur koha

1. Vrasësit nuk kanë pasur motive politike

Më 2 janar 2012, më thirri Faridin Tafallari në telefon, dhe më tregoi se Donika Gërvalla e paska thirrë Ramiz Dërmakun dhe i paska thënë, se lënda e atentatit nga policia e Heilbronit ka kalua në Berlin dhe se më 7 janar 2012 do të ketë një komunikim për TV e media tjera, duke ia tërhequr vëmendjen që të të jetë i informuar, ta përcjell lajmin gjerman dhe të shkruaj diçka për këtë në mediat shqiptare.

Më 4 janar 2012 e thirra Faridinin dhe biseduam rreth "informatës" së Donikës. Donika paska thënë se vrasësit janë zbuluar, se qenkan nga Fushë-Kosova, dhe shprehë ngushëllime se qenkan shqiptar, se motivi i tyre nuk ka qenë politik, por këtë e kanë bërë se kanë qenë të paguar. Dhe më tej Donika tregon, se vrasësi ia ka lënë një letër në xhep Jusufit dhe se atë letër policia ende nuk e ka gjetë dhe se po bën hetime me personelin e spitalit. Donika paska pasë me tregua edhe plotë gjëra të tjera, por nuk ka mund të flasë më gjatë se fëmijët e kanë kërkuar në ato momente vëmendjen e saj. (Trik i regjisorëve të pamëshirshëm të serialeve të ndryshme, për t'i lënë gojëhapur, në siklet e vuajtje të papërshkrueshme, pa marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore, shikuesit deri në epizodën tjetër.) Në bisedë e sipër Faridini më tha se është shumë mirë që ti arrite me e botuar librin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" pasi Donika dhe policia gjermane qenkan në prag të publikimit të emrave të vrasësve. Nuk po e kuptoj se kend ka dashtë me e trembë apo me e testue me këtë lojë që e ka bërë Donika në llogari të familjes së vet. Këtë lloj dezinformate, të cilës në fillim i besova deri diku (pasi e kisha shumë vështirë me e marrë me mend se Donika luan me gjëra të tilla) ia përcolla, si informatë interesante Sh. M. në Zvicër dhe A.M. në Suedi. Nuk shkoj gjatë dhe kësaj loje e këtyre testimeve të turpshme iu doli duçi.

Të shpërndash dezinformata përmes telefonit nëpër Evropë se *Vrasësit nuk kanë pasur motive politike* është jashtëzakonisht afër shprehjes: *Vrasja nuk është bërë për motive politike.*

2. Kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes

Donika Gërvalla: "Deri sot kam **heshtur** rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

3. Kam heshtur rreth asaj që kam mësuar

Donika Gërvalla: "Kam **heshtur** edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth miqve të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim. Kam mësuar shumë edhe për armiq të tij, të cilët si atëherë ashtu edhe sot, shtiren sikur kanë qenë shokë të tij." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

4. Kam heshtur edhe prej moshës 10-18 vjeçare

Donika Gërvalla: "Unë kam qenë 10-vjeçare kur u vra Babi në Gjermani. Vrasja u krye nga profesionistë të Sigurimit jugosllav. Jusuf Gërvalla vdiq më 18 janar 1982, në

orën tre të mëngjesit në spital, si pasojë e atentatit të ushtruar më 17 janar ndaj tij, vëllait të tij Bardhoshit, si dhe mysafirit të tyre, Kadri Zeka. Rreth rrethanave të vrasjes kam **heshtur** 30 vjet." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

5. Nuk duhet të heshtin dëshmitarët

Donika Gërvalla: "Nuk duhet të **heshtin** më dëshmitarët e kohës që i njohin të gjitha këto **fakte**." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

6. Nuk duhet të heshtet as për atë burrë që e dërguan me armë tek Babi

Donika Gërvalla: "Nuk duhet të **heshtet** as për atë burrë që e dërguan me armë tek Babi në shtëpi që ta vriste. Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte miqësia që i ofroi. Po i njëjti person, një atdhetar i flaktë dhe i pakompromis, nga të njëjtët njerëz dërgohet në Kosovë, bie në kurth dhe dënohet me 14 vjet burg. Një viktimë e regjimit jugosllav dhe njëkohësisht një viktimë e tradhtisë shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Agron Bajrami: Thuani se edhe pretendimi i tij për Riza Salihun se ishte pjesëmarrës në atentat, është i pavërtetë!?

Donika Gërvalla: "Unë nuk e di a është i vërtetë apo i pavërtetë por unë që e njoh të gjithë përmbajtjen e dosjes hetimore se ka shumë vite që merrem me çdo detaj, nëse unë nuk e di se ka qenë Riza Salihu atëherë nuk mund ta di as Ibrahim Kelmendi se ka qenë Riza Salihu dhe mua më duket paturpësi shumë e madhe që t'i vësh gishtin një personi tjetër për çfarëdo lloj motivesh qofshin ato dhe thua se ky ka qenë. Me këtë unë nuk dua të arsyetoj Riza Salihun sepse Riza Salihu është një burrë i keq, Riza Salihu është një burrë dinak dhe tinëzar. Riza Salihu është personi i cili ka qenë i dënuar nga organet gjermane për shkak se postën personale të babait tim e ka vjedhur, d.m.th. duke shkelur ligjin. Mirëpo nuk duhet përzier gjërat njëra me tjetrën." (Kohavision, 18 maj 2012)

7. Le ta thyejmë heshtjen së bashku…

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

8. Cila është ajo heshtje që duhet thyer?

Agron Bajrami: "E nisa emisionin me ngjarjen tragjike, me ngjarjen e cila tmerroi shqiptarët, me vrasjen e Jusuf Gërvallës, babait tuaj dhe Bardhoshit, vëllaut të Jusufit, axhës suaj dhe Kadri Zekës. Në një shkrim para disa muajsh në përvjetorin e tridhjetë të vrasjes, në Koha Ditore, ju thatë se Duhet thyer **heshtja**. Me çka e thyen **heshtjen** dhe cila është ajo **heshtje** që duhet thyer. Na tregoni pak." (Kohavision, 18 maj 2012)

9. Heshtja për të cilën kam folur nuk ka të bëjë me rrethanat e vrasjes

Donika Gërvalla: "**Heshtja** për të cilën kam folur ndoshta nuk ka të bëjë direkt me rrethanat e vrasjes por ka të bëjë me një temë më të gjerë e që lidhet drejtpërdrejt me Jusuf Gërvallën, me babain tim." (Kohavision, 18 maj 2012)

10. Kërcënimi i detyron këta njerëz të heshtin

Agron Bajrami: "Po kjo qeveri që e përmendni ju nuk është vetëm me njerëz prej LPK. Ka edhe njerëz të LDK-së, madje shumë të afërt të Ibrahim Rugovës që janë brenda.

Donika Gërvalla: Natyrisht që nuk është vetëm e LPK-së. Unë mora këtë segment që unë e kam shumë të afërt, që unë e ndiej, kur dikush fillon dhe dy fjali i thotë unë e shoh se ky ka kaluar shumë kohë gjatë me pasardhësit e Fatos Nanos ose me mësuesët e tij. Fatkeqësia është edhe ajo, unë shoh shumë miq të vjetër të asaj kohe, njerëz të cilët gjatë viteve 90-të kanë lëvizë në Kosovë shumë procese. I shoh sot janë këshilltar, kanë një vend komod pune dhe ndoshta edhe kërcënimi me papunësi, ndoshta kërcënimi me atë që nesër, pasnesër mund të rrish në shtëpi, të dalësh në pension dhe të mos kesh asnjë ndikim në jetën politike i detyron këta njerëz të **heshtin**. Ka edhe diçka tjetër. Krimi i organizuar nuk vetëm krim ekonomik në Kosovë. Krimi i organizuar është krim që përfundon me vrasjen e njerëzve në mes të rrugës. Prandaj, frika. Nuk mendoj që mund të kërkohet nga shqiptarët në Kosovë që me dekada të tëra të jetojnë me frikë dhe megjithatë të ngulin këmbë." (Kohavision, 18 maj 2012)

11. Ka ardhur koha të mos heshtet

Donika Gërvalla: "Unë jam rritur me një baba i cili nuk ka pasur frikë dhe të kthehem tek ajo se ka ardhur koha të mos **heshtet**." (Kohavision, 18 maj 2012)

12. Kam pretendim që në Kosovë ka ardhur koha

Donika Gërvalla: "Babai nuk ka **heshtur**. **Kam atë pretendim** që në Kosovë ka ardhur koha të mos **heshtet**. Të gjithë e dimë realitetin, të gjithë e dimë që për një deklaratë ose për 500 euro që dikush nuk i paguan haraç dikujt që vjen t'ia kërkoj mund të vritesh vet, mund të vriten pjesëtarët e familjes, mund të kidnapohen fëmijët. Prandaj për një realitet që ne e njofim mjaft mirë, kë presim që të vij dhe të na e ndryshoj?" (Kohavision, 18 maj 2012)

Donika Gërvalla: "Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik." (17 janar 2010, http://gervallablog.com)

ASNJËHERË NUK ARRITËN TË BËHEN SHOKË

1. Miku Kadri Zeka
2. Kadri Zeka, miku i ardhur
3. 28 Vjeçari ka pasur tensione me 36 vjeçarin
4. Mysafirit të tyre Kadri Zeka
5. Nuk është folur asnjëherë
6. Babi dhe Kadri Zeka
7. Kadri Zeka ishte shpesh i pranishëm
8. Babi angazhohej me ftesë të Kadriut
9. Liria botohej nga Kadri Zeka
10. Relatat mes Babit dhe Kadri Zekës
11. Asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë
12. Babi dhe Kadri Zeka në luftën e përbashkët

Raporti i Jusufit dhe Kadri Zekës është i sqaruar në tërësi, në librin tim "LËVIZJA E JUSUF GËRVALLËS, Tetor 2011. Prej marsit 1981 deri më 17 tetor 1981 është raport i mirë, shoqëror, **sa i përket anës së Jusufit, dhe në këtë rast kjo duhet të jetë primare**. Pas 17 tetorit 1981 raporti shoqëror prishet, pasi bëhet i njohur keqpërdormi i punës dhe ndihmës së Jusufit për revistën "Liria". Megjithatë, në të gjitha letrat e Jusufit, pamvarësisht afrimeve e distancimeve, Kadri Zeka përmendet vetëm si shok dhe asnjëherë nga Jusufi ai nuk "degradohet" në ***mik***. Nga Donika Gërvalla bëhet përpjekja që Jusufi dhe Kadri Zeka të reduktohen në persona privat (si Babi dhe Kadriu) të xhveshur krejtësisht nga shokët dhe organizatat e tyre. Si në rastin e Jusufit e aq më tepër në rastin e Kadriut, ku ajo nuk ka asnjë të drejtë, as teorike, tentimet e tilla janë të destinuara për dështim.

1. Miku Kadri Zeka

Jusuf Gërvalla: "I dashur **vëlla**, Mërgim!

...Letrat e tua dhe materialet e shkruara i mora me kohë. Por, i lejova vetes të ta vonoja pak përgjigjen, për arsye se isha i zënë me disa punë të nisura, shumë të ngutshme. Me një **shok** të "Lirisë" (Kadri Zekën-shën. i Xh. D.) organizuam në Zvicër dhe në RFGJ katër demonstrata të punëtorëve kosovarë në botën e jashtme, dhe jemi në prag të organizimit të demonstratës së pestë. Duheshin shkrime, trakte dhe fjalime, pastaj, duhej një vrap i madh për tubimin e njerëzve." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeäare ndaj Jusuf G, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2007-2009)

Jusuf Gërvalla: "Tani, në bashkëpunim me komunistët gjermanë e zvicëranë, unë dhe një **shok** i "Lirisë" (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.) jemi duke punuar në formimin e disa komiteteve për Kosovën. Këto komitete do të përbëhen prej autoritetesh të njohura

gjermane e zvicërane, si politikanë, shkrimtarë e artistë të njohur demokratë." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

2. Kadri Zeka, miku i ardhur

Jusuf Gërvalla: "Konkretisht, në komitetin që do të formohet në Gjermaninë Federale, kemi rënë dakord që nga pala shqiptare të hy unë, kurse në atë në Zvicër, një **shoku** i "Lirisë" (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.). Komitetet kanë për qëllim ta sheshojnë të vërtetën për Kosovën dhe të organizojnë ndihma të ndryshme për popullin tonë të shumëvuajtur." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

Donika Gërvalla-Schwarz: "Në mëngjesin e 17 janarit 1982 askush nuk parashikoi se çfarë do të sillte kjo ditë. Kadri Zeka, **miku i ardhur** një ditë më parë në Untergruppenbach kishte planifikuar që atë ditë të kthehej në Zvicër. (17 janar 1982, http://gervallablog.com, 17 janar 2010)

Jusuf Gërvalla: "Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai **shoku** i "Lirisë" (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.), me të cilin kemi bashkëpunuar qe disa kohë. Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasëve, edhe LNÇKVSH edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

3. 28 Vjeçari ka pasur tensione me 36 vjeçarin

Jusuf Gërvalla: "Lidhur me këtë, ai ka një propozim konkret, të cilin ia kam aprovuar edhe unë, nëse pranon ti: të vijmë së bashku ai e unë te ti dhe ta ndriçojmë po qe e mundur këtë çështje. Fitimi, besoj, do të kish qenë i madh. Ai (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.) është një **shok** i mirë dhe mjaft i pjekur. Por, në qoftë se ti ngul këmbë që nuk duhet t'i hymë fare kësaj pune, atëhere ashtu edhe do të bëhet." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

Donika Gërvalla-Schwarz: "**Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka**
Është e vërtetë që mes 28-vjeçarit Kadri Zeka dhe 36-vjeçarit Jusuf Gërvalla ka pasur tensione. (17 janar 1982, http://gervallablog.com, 17 janar 2010)

Jusuf Gërvalla: "Edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Po ky **shoku** i "Lirisë" (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.), i cili lidhjet me **shokët** në Kosovë i mban rregullisht, tash së fundi na njofton sesi nga Kosova i paska ardhur porosia që tash e tutje të mos ngulim më këmbë në kërkesën për përfshirjen e tokave shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi brenda republikës së Kosovës, por të kufizohemi vetëm me statusin e republikës për territorin e sotëm të Krahinës Autonome të Kosovës, sepse gjoja, po të paraqitet kështu çështja, paska

njëfarë mangësie për realizimin e kësaj kërkese." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

4. Mysafirit të tyre Kadri Zeka

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim. Kam mësuar shumë edhe për armiq të tij, të cilët si atëherë ashtu edhe sot, shtiren sikur kanë qenë shokë të tij. (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:

A e aprovon ardhjen time bashkë me atë **shokun** (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.), lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon....

A mendon se duhet edhe më tutje, pas këtyre njoftimeve, ta vazhdoj bashkëpunimin me **shokun** (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.) në fjalë, apo të punoj vetëm, duke iu kushtuar kryekëput punëve të LNÇKVSH dhe të organit të saj të ardhshëm?

Të lutem t'i analizoni hollësisht këto çështje me **shokë** dhe të më përgjigjeni sa më parë që të jetë e mundshme." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

Donika Gërvalla: "Unë kam qenë 10-vjeçare kur u vra Babi në Gjermani. Vrasja u krye nga profesionistë të Sigurimit jugosllav. Jusuf Gërvalla vdiq më 18 janar 1982, në orën tre të mëngjesit në spital, si pasojë e atentatit të ushtruar më 17 janar ndaj tij, vëllait të tij Bardhoshit, si dhe **mysafirit** të tyre, Kadri Zeka. Rreth rrethanave të vrasjes kam heshtur 30 vjet." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ibrahim Kelmendi... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij daje të vogël (Gani Ibërdemajt - edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori) dëshirën për t'u takuar me mua. Më vonë, kur ka qenë puna që të formojmë këndej një shoqëri kulturo-artistike të punëtorëve të mërguar, me **shokun** e "Lirisë" (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.) e kemi provuar Ibrahimin lidhur me dajën e tij të vogël: meqë ky Ganiu qenka këngëtar dhe instrumentist i mirë në vegla muzikore folklorike, Ibrahimi propozoi që edhe ai të hynte në atë shoqëri. Po kur erdhi puna te aktiviteti konkret, Ibrahimi tha se Ganiu donte pak "lutje"." (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" – **RAPORT** mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor, korrik 1981; U publikua nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Ibrahim Kelmendi*: "Nuk ish fort e pëlqyeshme, s'mu ka dukur atëherë, s'ka me m'u dukur kurrnjëherë në jetën time, kam drejt me e mbajt atë qëndrim. me thënë po e ngarkojmë me përgjegjësi (*Jusufin-shën i Xh.D*.) pse e kanë pranuar mysafir (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.), kur e din Ky (Faridin Tafallari-shën. i Xh.D.) e e dinë boll (ai) kallabllak, që kur janë çue prej odës* (së Murat Kryeziut, në Bernhausen, Nord-West-Ring 30, më 17 janar 1982 në ora 02.00-shën i Xh.D*.) ku jemi kanë duke i parë filmat,*

çfarë insistimi e këmbëngulje ka pasë Jusufi me e marrë ***mysafir*** (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.***)***. *A ne gjatë rruge jemi nisë për me shkue* ***mysafir*** *e kemi thënë që* ***ishalla do të na thirrë mysafir*** *se aty kanë qenë edhe qëllimet e fundit që prapë me u ulë, prapë me ba kompromise pamvarësisht që s'u muarën vesh se duhet me i vazhdua demonstratat duhet me e vazhdue aktivitetin.* ***E kemi thënë ishalla na thirrë mysafir,*** *ose ishalla, në fund tash kjo shprehja ishalla... në fund kemi dëshirua që prapë me u ulë e me e bashkua në të njejtin nivel si përpara.* ***E nëse nuk thirrë e kemi pasë bërë plan me shkua mysafir te Ky (*****Faridin Tafallari-shën i Xh.D.*****).*****"*** (Fjalë të inçizuara në magnetofon nga Mbledhja e Qendrës Ekzekutive në Gjenevë, më 3 mars 1984, Pjesa e tretë, minutat 10.00-12.00, Arkivi i Faridin Tafallarit)

Asnjë shok i Jusufit nuk e ka akuzuar Jusufin se pse e ka pranuar mysafir Kadri Zekën dhe as nuk ka guxuar kurrë me iu përzie apo me i dhënë mësime se kend duhet e kend nuk duhet me e pranua si mysafir. Por e vërteta që zbulohet, në hovin e kurdisjes së shpifjeve, është e një rëndësie të jashtëzakonshme.

5. Nuk është folur asnjëherë

Jusuf Gërvalla: "Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes **shokut** të "Lirisë" (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.)." (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" – **RAPORT** mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor, korrik 1981; U publikua nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Donika Gërvalla: "Në një kohë kur Kosova kërcënohej nga regjimi jugosllav dhe më vonë edhe më rëndë nga ai serb, rreth këtyre rrethanave **nuk është folur asnjëher**ë për të mos zbehur dhe rrezikuar edhe atë unitet të brishtë, i cili u krijua mes shqiptarëve në diasporë pas kësaj vrasjeje mizore." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: **Vëlla** i dashur, Mërgim!

Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit. ... Meqë me Organizatën e **shokëve** të "Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare dhe të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

6. Babi dhe Kadri Zeka

Jusuf Gërvalla: "Për veten time, në shërbim të kësaj çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e **shokut** me **shokun**, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa besë dhe me grushtin të bashkuar." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

Donika Gërvalla: "Babi dhe Kadri Zeka kanë bashkëpunuar për arritjen e qëllimit të tyre të përbashkët, lirinë e Kosovës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i **shokut** Z. (Kadri Zekës-shën. i Xh.D.) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i **shokëve** të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

7. Kadri Zeka ishte shpesh i pranishëm

Jusuf Gërvalla: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me **shokun** Z.– Kadri Zekën-shën. i Xh.D.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

Donika Gërvalla: "Kadriu ishte shpesh i pranishëm në demonstratat që organizoheshin në Gjermani." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen **shoku** Z (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.). Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

8. Babi angazhohej me ftesë të Kadriut

Jusuf Gërvalla: "Kam dëshirë të madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.

Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre **shokëve**, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim e satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

Donika Gërvalla: "Babi, si gazetar me shumë përvojë, angazhohej me ftesë të Kadriut për një përmbajtje sa më cilësore të gazetës „Liria", që botohej në atë kohë nga Kadri Zeka." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën. Veçse, një mësim duhet nxjerrë : sinqeriteti - për **shokët** e sinqertë. (Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre, kur nuk dhanë asnjë shenjë! Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)" (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

9. Liria botohej nga Kadri Zeka

Jusuf Gërvalla: "Mirëdita, **shok**u Z!

Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga **shokët** e Lëvizjes." Letër për Kadri Zekën, dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

Donika Gërvalla: "Babi, si gazetar me shumë përvojë, angazhohej me ftesë të Kadriut për një përmbajtje sa më cilësore të gazetës „Liria“, që botohej në atë kohë nga Kadri Zeka. Njëjtë vepronte edhe me gazeta të tjera që botoheshin në diasporë. Ai donte që të flitej fuqishëm dhe me një gjuhë të përbashkët." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të **shokëve** të Organizatës m-l)." (Letër për Kadri Zekën, dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

10. Relatat mes Babit dhe Kadri Zekës

Jusuf Gërvalla: "Për mua konkretisht, dhe **shokët** e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në “Thirrje”, ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konseguencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta.

Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se keni bërë përpjekje për t’i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha,. me manovrime nga ana juaj.

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave." (Letër për Kadri Zekën, dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një **shoku** (Kadri Zekës-shën. i Xh.D.), që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë." (Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

11. Asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë

Jusuf Gërvalla: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët** e tu të rinj (OMLK-shën i Xh.D.) e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisinin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij." (Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Donika Gërvalla: "Ata asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta. Babi asnjëherë nuk ka punuar me kërcënime, nuk ka mbajtur armë, madje as atëherë kur nuk kishte më asnjë dyshim, se sa në rrezik ishte jeta e tij." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. **Shoku** Z. (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.) i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij **shokut** të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar **shokut** Z. (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.)" (Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

12. Babi dhe Kadri Zeka në luftën e përbashkët

Jusuf Gërvalla: "Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu. Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë. Me këtë rrugë, për të njejtën çështje po e njoftoj edhe **shokun** Z. (Kadri Zeka-shën. i Xh.D.), megjithqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon." (Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Donika Gërvalla: "Por Babi dhe Kadri Zeka në luftën e përbashkët për liri përpiqeshin të arrinin megjithatë një bashkim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shoku** Z.!

Njëherazi shfrytëzoj rastin t'ju përgëzoj edhe njëherë për martesën dhe t'ju uroj trashëgim të frutshëm shqiptar." (Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 284-285)

Donika Gërvalla: "Përkundrazi, edhe më madhështore na duken në retrospektivë këto figura, kur e dimë që bashkonin forcat në luftë për çlirimin e Kosovës, edhe pse personalisht mund të kishin rezerva ndaj njëri-tjetrit." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Avni Klinaku "Ranë, pasi e vulosën dokumentin e bashkimit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. LAVDI!" (facebook, 17 janar 2013)

Donika Gërvalla: "Pikërisht më 17 janar, pra ditën e atentatit, ata u liruan mjaft me njëri - tjetrin. Nga shtëpia dolën duke qeshur me të madhe dhe duke bërë shaka. Mjaft tragjike që ata vriten pikërisht në këtë ditë të afrimit të tyre." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Avni Klinaku "Ranë, pasi e vulosën dokumentin e bashkimit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. LAVDI!" (facebook, 17 janar 2013)

Donika Gervalla-Schwarz: " Z. Avni Klinaku, as atë natë dhe as në ditët, javët apo muajt më parë as nuk është nënshkruar dhe as nuk është vulosur asnjë lloj dokumenti. Përhapja e gënjeshtrave të tilla nuk i bën nder askujt, e aq më tepër më 17 janar." (facebook, 17 janar 2013)

I DASHUR SHOK

Në këtë kapitull ilustrohen përpjekjet e Donika Gërvallës, për ta xhveshur Jusufin nga rrethi i tij, nga shokët e tij të cilët i ka respektuar dhe të cilët e kanë respektuar me të njejtën masë, ndoshta edhe më të madhe edhe pse nuk kanë ditur ta shprehin gjithmonë. Me përbuzjen, nënçmimin e shokëve të luftës, dhe me përpjekjen për lansimin e "miqëve" qëllimi është që të privatizohet historia e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, lufta e mërgimtarëve shqiptar në Gjermani, sidomos në periudhën 1980-1981.

Në këtë kapitull kam zgjedhur 85 citate të Jusufit ku ai deklarohet për shokët e tij dhe u drejtohet atyre. Me aq sa e kam studiuar veprën politike të Jusufit, ai vetëm në dy-tri raste e përdor termin "mik" (në revista), më shumë në kuptimin e farefisnisë.

Kundrejt fjalëve të Jusufit kam zgjedhë 18 citate të Donika Gërvallës për t'i ilustruar qëllimet, e pretendimet e saj. Shprehjet e Jusufit nuk përsëriten asnjëherë, të Donikës përsëriten aq sa është e nevojshme për të krijuar ballafaqime të plota.

Disa fjalë sqaruese e definuese për fjalën "MIK" nga fjalori i shqipes.

MIK, MIKU, MIQ, MIQTË
- Dashamir, Ai që na e do të mirën dhe na ndihmon,
-Ai që na vjen në shtëpi për të bujtur, ose si i ftuar, mysafir;

-Secili nga meshkujt e familjes së nuses (babai, vëllai etj.) kundrejt njerëzve të dhëndrit.

- Dikush të cilit nuk ia dimë emrin ose nuk duam t'ia përmendim emrin; një njeri. *E takove atë mikun?* ***Kështu, lum miku.***

LUM E LUM PËR MIKUN DHE DASHAMIRIN

Jusuf Gërvalla: "***Ç'pate lum "dashamiri"****, që u drodhe me kaq frikë në Kosovë kësaj radhe?"* (Letër e hapur J. B. Tito, Janar 1980; Bashkimi, shkurt 1980, faqe 1)

Jusuf Gërvalla: "Ç'quan armik të përbetuar goja e burrave përreth, quan mik për kokë kënga e Balisë:

"Marshall Tita n'kali t'bardh'..."

ose

*"**Lum e lum** për këtë Kosmet,*
na ka ardhë Tita n'poset..."

(Kopili i eposit, Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 16)

Disa fjalë sqaruese e definuese për fjalën "SHOK" nga fjalori i shqipes.

SHOK, SHOKU, SHOKËT

-Njeri me të cilin jemi lidhur me miqësi gjatë jetës; njeri me të cilin kemi pikëpamje, mendime e interesa të përbashkëta, kemi moshë pak a shumë të afërt dhe shkojmë mirë njëri me tjetrin; njeri me të cilin gjendemi së bashku në disa rrethana të caktuara. *Shok i mirë. Shok fëmijërie (shkolle). Shok armësh* bashkëluftëtar për një çështje të përbashkët revolucionare e atdhetare.

Thuajmë ç'shokë ke të të them cili je.

- Ai që është i ngjashëm me dikë nga aftësia për një punë ose nga një veti e karakterit etj. *I ka shokët të rrallë* shquhet, dallohet shumë ndër të tjerët. *Nuk i gjendet shoku* nuk ka ndonjë tjetër të ngjashëm me të për nga vetitë, nga cilësitë etj.

* **Vëllezër jemi, shokë s'jemi** mund të jemi vëllezër, të afërt nga gjaku, por mund të kemi tipare, pikëpamje e synime të ndryshme dhe të mos shkojmë mirë me njëri tjetrin.

1.

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeçare ndaj Jusuf Gërvallës, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2009)

Jusuf Gërvalla: "Unë e ndala dritën dhe ndenjëm ashtu në terr me Suzanën për ndonja një orë, duke u shtirë se po flemë (për ata që do të kenë përgjuar eventualisht përjashta). Më vonë u përshëndeta me Suzanën, duke i treguar se ndoshta **shokët** do të më këshillojnë të arratisem.

Ajo u pajtua, pa fjalë, dhe unë ika, duke i lënë fëmijët në gjumë.

Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata." (Vepra, Vëll. 4, Prishtinë 2010, faqe 246)

2.

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Shkroi edhe "Rilindja" e 21 nëntorit për një **vëlla** tonin, i cili, në çastin që doli gazeta (e mallkuar) ishte i burgosur dhe nuk arriti të lexojë gjë për aktin e madh njerëzor që kish bërë vetë, duke e ndihmuar me të madhe edhe Ndihmën e Shpejtë për t'u dalë përballë kërkesave të popullsisë, që po përjetonte çaste nga më të vështirat. Këtë e bëri ai, **Shoku** Bilall Osmani, punëtor në "INA". Ai duke luftuar me armë të thjeshtë, kofë, ia arriti që ujin e tërbuar mos ta lenë të futet në fuqinë nën tokë, ku do të përzihej me benzinë. Kështu, ishte e vetmja pompë në rrethin e Prizrenit që funksiononte. Kur në mëngjes shkuam të mësojmë diç më shumë për sakrificat që i kishte bërë gjatë tërë natës, **Shokun** Bilall e kishin arrestuar kusarët e UDB-së!" (Uji vërshonte – UDBa burgoste patriote e patriotë, Bashkimi, shkurt 1980, faqe 2)

3.

Donika Gërvalla: "Babi im vendosi shumë shpejt të dëgjojë zërin e popullit në Kosovë dhe e përkrahu menjëherë kërkesën për Republikë, gjë që nuk i solli vetëm **miq** në radhët e diasporës shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Para detyrave dhe të drejtave që kërkon dhe ofron atdheu, të gjithë jemi njësoj. Por, s'do mend që për atdhe shumë më tepër i takon të luftoj atij që ka më shumë mundësi. E mundësi, ndër kryesoret, në kushtet bashkëkohore, është vetëdija e lartë kombëtare e historike, e vënë pa kursim në shërbim të çështjes së lirisë. Në këtë drejtim, **shoku** intelektual dhe shoqja intelektuale, neve na kanë dhënë mend njerëzit e thjeshtë. Ata nuk iu ndanë asnjëherë luftës së ngulmët me mundësitë që kishin. Kurse ne, të shumtën e herave, s'e prishëm që se prishëm "qetësinë" dhe "rehatinë" tonë. Kemi shembuj të disa **shokëve** që për çështje kombëtare kanë rënë në burgje që në bankat e shkollës së mesme." (Letër një shoqi intelektual, Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

4.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Dhe në atë log, ku do të duhej të dilnim ne - e nuk dalim, sepse na ka mbërthyer obsesioni se jemi të ndjekur e të përgjuar - atje del dhe e merr fjalën ai, armiku. Kemi këtë rezultat: ndjekësi, përgjuesi fashist jugosllav është i organizuar, i stimuluar nga pushteti, intelektuali shqiptar është i çorganizuar dhe frikësohet nga **shokët**, vëllau, nga hija e vet; përparësia e agjentit dhe policit jugosllav vjen duke u shtuar gjithnjë në dëm të aktivitetit të intelektualit kosovar." (Letër një shoqi intelektual, Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

5.

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeçare ndaj Jusuf Gërvallës, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2009)

Jusuf Gërvalla: "Kapitalizmi botëror jo rastësisht e mbështet kaq shumë politikisht dhe financiarisht 'vetadministrimin' jugosllav dhe i mban iso propagandës titiste për ta shitur këtë sistem si 'formë të re të sprovuar të ndërtimit të socializmit' për të gjitha vendet." E ti, **shoku** intelektual, e di, më mirë se të tjerët, që pasojat më shkatërrimtare të këtij 'vetadministrimi' thyhen mbi kurrizin e Kosovës dhe se kaosi më i madh mbretëron pikërisht në viset shqiptare në Jugosllavi." (Letër një shoqi intelektual, Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

6.

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Qëndresa heroike dhe veprimtaria revolucionare e **Shokut** Adem Dema-Demaçi, duhet të jetë shembull veprimi i qëndrimi për të gjithë militantët shqiptarë!" (Programi dhe statuti i Frontit të Kuq Popullor, maj 1980)

7.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ta kanë arrestuar djalin, vajzën, vëllaun, motrën, burrin, babanë apo **shokun**. Më së miri do t'ia nxjerrësh hakun nëse menjëherë i kërkon radhët e organizuara dhe hidhesh në luftë të organizuar revolucionare." ("BASHKIMI" BËN FUQINË, BASHKIMI, Nr.1, Janar 1981, faqe 2)

8.

Donika Gërvalla: "Babi im vendosi shumë shpejt të dëgjojë zërin e popullit në Kosovë dhe e përkrahu menjëherë kërkesën për Republikë, gjë që nuk i solli vetëm **miq** në radhët e diasporës shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "22-vjeçari i sotëm ende nuk ka qenë i lindur, kur UDB-ja e pat burgosur herën e parë për veprimtari patriotike **shokun** Adem Dema-Demaçi, në vitin 1958. Sot këtë 22-vjeçar e kemi burrë të rritur e të pajisur me vetëdije të lartë kombëtare e klasore dhe me një gatishmëri e guxim të pashoq për t'u futur si e kërkon nevoja në zjarrin e luftës e të revolucionit. Në qoftë se ai është aftësuar edhe në pikëpamje organizative, atëherë, për kauzën tonë kanë ardhur kohë të mbara." ("BASHKIMI" BËN FUQINË , BASHKIMI, Nr.1, Janar 1981, faqe 2)

9.

Donika Gërvalla: "Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Kujto sidomos **shokun** Adem Dema-Demaçi, i cili e ka më të shtrenjtë të vërtetën dhe të drejtën e popullit të vet sesa rininë dhe jetën në robëri." (Korrespondenti popullor, Bashkimi, janar 1981, faqe 3)

10.

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeçare ndaj Jusuf Gërvallës, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2009)

Jusuf Gërvalla: "Pastaj, si intelektualë që jeni, nëse e zotëroni sado pak shkrimin, do të dini t'i lidhni faktet ashtu si e implikon logjika e objektivitetit dhe jo demagogjia revizioniste. Nëse nuk keni prirje vetë për shkrim, gjejeni **shokun** dhe "furnizojeni" me informata." (Korrespondenti popullor, Bashkimi, janar 1981, faqe 3)

11.

Donika Gërvalla: "Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte **miqësia** që i ofroi." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Hysen Gegaj nga Sallagrazhda e Suharekës, ishte punëtor i mirë e shumë i dashur për **shokët** e vet, gjithnjë i gatshëm t'i ndihmojë pa kursim të tjerët. Edhe ai, me një gëzim të madh u nis për në vendlindje, ku arriti natën e Vitit të Ri. Në shtëpi e pritnin me mallë babai i rrezbitur, nëna plakë, shoqja, vëllezërit, fëmijët e mitur. I harroi vuajtjet e përjetuara gjatë qëndrimit të tij në kurbet. Jeta po i dukej sërish e bukur. Tjetër dhe ish ky, tjetër erë binte këtu athëtima e dimrit, rruga e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta. (KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!, Lajmëtari, janar 1981, faqe1)

12.

Donika Gërvalla: "Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte **miqësia** që i ofroi." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Si u përshëndet me prindërit e me fëmijët, sa u çmall pakëz, Hyseni doli në fshat tek **shokët** e moçëm dhe ndenji me ta deri pak para mesnate." (KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!, Lajmëtari, janar 1981, faqe1)

13.

Donika Gërvalla: "Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte **miqësia** që i ofroi." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Në shtëpi e pritnin me padurim. Druanin se do ta kalonin pa të edhe këtë Vit të Ri. E dinin se ai harrohej fare kur ishte me **shokët.** I tillë kish qenë qysh fëmijë, kur i ruante lopët e fshatit, për t'ia shtuar një kafshatë bukë familjes. I tillë kishte qenë edhe në kohën e rinisë së hershme, kur iu desh ta regjte shtatin e njomë me peshat e

rënda të betonit e të tullave, në punishtet ndërtimore të Beogradit." (KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!, Lajmëtari, janar 1981, faqe 1)

14.

Donika Gërvalla: "Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte **miqësia** që i ofroi." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Për **shokë** jepte gjithçka edhe tash. Veçse tash vinte pak më thatim e gjithnjë më hijerëndë. Dhe sikur kishte ca brenga të thella për moshën e tij." (KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!, Lajmëtari, janar 1981, faqe1)

15.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shoku** Enver!

Prandaj, duke marrë pëlqimin e **shokut** të parë të Lëvizjes, anëtar i Komitetit Qendror, unë u arratisa aty për aty. Më datë 21 dhjetor arrita në Ludvigsburg të RF Gjermane dhe u strehova te vëllau im i vogël Bardhosh Gërvalla, i cili këtu punon që nga viti 1974." (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

16.

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Unë, me të arritur në Ludvigsburg, i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej **shokëve** të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaport e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej **shokëve** të Ambasadës së përmendur." (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

17.

Donika Gërvalla: "Babi im vendosi shumë shpejt të dëgjojë zërin e popullit në Kosovë dhe e përkrahu menjëherë kërkesën për Republikë, gjë që nuk i solli vetëm **miq** në radhët e diasporës shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nga **shokët** e Kosovës më vinin kohë pas kohe porosi që të ruhesha, sepse UDB-ja, e cila është mësuar t`i qërojë me likuidime fizike hesapet me disa ustashë kroatë, kinse nuk qenka larg vendimit që një praktikë të tillë ta aplikojë edhe me shqiptarët në botën e jashtme. Nuk mund të them se s`më kanë bërë ndonjë përshtypje këto sugjerime të **shokëve**, por as njerëzve të UDB-së këtu, megjithë marrëveshjet dhe bashkëpunimin jugosllavo-gjerman, nuk ua kam aq shumë frikën." (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

18.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, **shoku** Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë." (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

19.

Donika Gërvalla: "Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, **shoku** Enver." (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

20.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nuk ishte punë e lehtë për mua të vendos që të Ju drejtohem Ju, **shoku** Enver, për një çështje që ndoshta nuk është e denjë te merreni me të. (U botua së bashku me punimin e Faridin Tafallarit, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

21.

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shoku** Enver!

Dhe hyri me të drejtë në histori si epokë e Prometheut kundër të gjithë perëndive, epokën e sotme shqiptare me Partinë e Punës dhe me Ty në krye **shok**u Enver. Skena e dramës së sotme shqiptare është po ajo e Prometheut të pesëqind vjetëve. (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

22.

Donika Gërvalla: "Babi im vendosi shumë shpejt të dëgjojë zërin e popullit në Kosovë dhe e përkrahu menjëherë kërkesën për Republikë, gjë që nuk i solli vetëm **miq** në radhët e diasporës shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Na bën të lumtur fakti se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Ti, **shoku** Enver, jo vetëm që keni ndjekur në hap të gjitha konjugacionet e gjenocidit sllavomadh të ushtruar mbi ne, por keni qenë edhe të vetmit denoncues të denjë të këtij gjenocidi në sy të botës." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

23.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nga ana tjetër, ne aprovojmë pa rezervë parimin marksist-leninist të PPSH, lidhur me rivendikimin e kufijve. Mirëpo, nga përvoja 35 – vjeçare me titizmin, a mund të priten rrethana të rivendikimit në rrethana marksiste-leniniste? Te ne nuk do të lëkundet kurrë besimi në revolucionaritetin e popujve. Kjo vlen edhe për popujt jugosllavë. Ti, i dashuri **shoku** Enver, ke konstatuar vetë se klima politike në Jugosllavi është e atillë që në të mund të pritet shpërthimi i revolucionit nacionalist." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

24.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Aktualisht, siç e di edhe Ti, **shoku** Enver, te ne vazhdon eksplorimi i paskrupullt ekonomik i viseve shqiptare nga ana e qeverisë së Beogradit. Vazhdon me të madhe papunësia dhe shitja e krahut të lirë të punës te kapitalistët perëndimorë." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

25.

Donika Gërvalla: "Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ndonëse të zbuluara e të ndëshkuara, në luftën tonë të përgjithshme kanë kontribuar shumë grupet dhe organizatat patriotike e revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej. Është mbarësi e posaçme që pjesa e tyre dërmuese ka pasur platformë të shëndoshë ideopolitike. Ato mund të mburren, se kanë ndjekur rrugën e luftës nacionalçlirimtare dhe revolucionit socialist,

duke synuar në mënyrë permanente bashkimin e tokave dhe të popullit e me vullnetin e popullit, me vendin amë, Shqipërinë socialiste të Partisë së Punës dhe të **shokut** Enver." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

26.

Donika Gërvalla: "Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth **miqve** të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Duke çmuar lart kohën Tënde të shtrenjtë, **shoku** Enver, shpresoj se do të kesh mirësinë t'i propozosh ndonjërit nga **shokët** e afërm të Partisë së Punës të më përgjegjet në këtë letër. Çdo fjalë, çdo mendim a porosi do të jetë shumë efektive dhe jo vetëm për mua." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

27.

Donika Gërvalla: "Babi im vendosi shumë shpejt të dëgjojë zërin e popullit në Kosovë dhe e përkrahu menjëherë kërkesën për Republikë, gjë që nuk i solli vetëm **miq** në radhët e diasporës shqiptare." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Po ashtu, „përkundrazi", i nderuar shok Ibrahim!

Kështu duket titulli-pasthirrmë i letrës sime, që i përgjigjet besnikërisht tëndes. **Edhe sa e sa gjëra të tjera të çuditshme do të kishim, sikur unë t'i përgjigjesha pikë për pikë gjithë përmbajtjes së letrës sate.** Ndoshta para teje me edhe s'do të kish pasur gjë të keqe, por të na çuditej bota për rasat nëpër të cilat ditka të lakohet mendimi i sotëm i revolucionarit shqiptar." (Letër për Ibrahim Kelmendin, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

28.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde) ç'mundime ke pasur të më shkruash në "nivelin" tim, sikur thua se **vetëm në "nivelin" tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit!** E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se **ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit**?! Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.) [J.G]" (Letër për Ibrahim Kelmendin, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

29.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shok**, Nuhi!

Herën e kaluar nuk patëm si të ishim të kënaqur nga takimi. Unë e kisha marrë me mend krejt ndryshe. Por, ne edhe më tej, në këto kushte, do të ballafaqohemi me vështirësi pasi kemi pak gjë në dorë." (Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30)

30.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Deri në takimin e ardhshëm do të kish qenë mirë që ju t'i jepni zor pak më konkretisht e më energjikisht në mbledhjen e ndihmave për **shok**un H." (Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30)

31.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nuk është mirë ta vonojmë këtë punë. Dhe sa më shpejt duhet ta gjejmë një **shok** të përshtatshëm, i cili do t'i dorëzojë në vend. Besoj se nuk e keni harruar dhe nuk e keni bërë "nazgjë" këtë punë." (Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30)

32.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ju porosis të shikoni ndonjë **shok** me bibliotekë të pasur dhe të merrni prej tij e ta lexoni librin e V. I. Leninit: "Ç'të bëjmë?". E gjeni në vëllimin 5 të kompletit të veprave të Leninit, nga faqja 401 deri në fund. Unë besoj se do ta gjeni, po të përpiqeni. Kurse leximi i kësaj vepre është i domosdoshëm." (Letër për Nuhi Sylejmain, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30)

33.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ju porosis, mbi të gjitha, që ta ruani sekretin, si jemi marrë vesh, për ato që kemi biseduar. Ne ndonjëherë mund të mos punojmë si duhet, si tash që i kemi rralluar takimet, gjë që dëmton vullnetin dhe moralin tonë. Por, të mos harrojmë se çështja kryesore mbetet ajo që është, dhe ajo asnjëherë nuk humbet asgjë nga shenjtëria e vet. Këto t'i keni parasysh, dhe jo ndonjë qëndrim të ndonjë **shoku**, se kështu mund të bëjmë gabime të pafalshme, duke e barazuar rëndësinë e vet çështjes me qëndrimet e përshtatshme a të papërshtatshme të **shokëve**.

Me përshëndetje të ngrohta **vëllazërore**, “Lajmëtari”" (Letër për Nuhi Sylejmain, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30)

34.

Donika Gërvalla: "Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shok**, Nuhi!

Më vjen keq që një nga bisedat tona të para serioze u bë duke kritikuar punën e të tjerëve, madje pa qenë ata prezentë. Ka mundësi të dalin keqkuptime dhe gjithë puna të merret si përgojim, por këtë gjë do ta bëjmë edhe ndërsy njerëzve që do t’i marrim në thumb, kurdo që të na ipet rasti." (Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30-32)

35.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Deri më tash, ata më kanë dhënë vetëm 200 DM për shtypjen në shtypshkronjë të “Lajmëtarit të Lirisë”, kurse marrëveshja ka qenë që të hollat për shtyp t’i sigurojnë ata, meqë unë nuk jam në gjendje të paguaj nga xhepi im. (Deri më tash, dy numrat e revistës i kam paguar me të hollat e mia, sikurse edhe makinën e shtypit, gjithsejtë mbi 9.000 DM, kurse kontribute nga **shokët** kam marrë gjithsejtë 1.300 DM.) Për këtë arsye, numri i parë (për këtë vit) më ka ndenjur qe më se dy javë i gatshëm, sepse nuk kisha të holla ta dërgoja në shtyp.
Mirupafshim, të dielën! (nënshkrimi origjinal i Jusuf Gërvallës) “Lajmëtari”
Të fala të përzemërta edhe **shokëve**, që s’po ua përmend emrin!" (Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30-32)

36.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I nderuar **shok**, Nuhi!

Druaj mos jam vonuar në këtë letër, për arsye të caktuara.
Në qoftë se e merr brenda ditës së sotme (e martë, 10 shkurt 1981), atëherë, të lutem që në përbërjen e herës së kaluar, të dalësh po në atë kohë dhe po në vendin e përparshëm në takim. Shpresoj se e keni lexuar me **shokë** materialin që more herën e fundit, se do të keni marrë edhe ndonjë qëndrim të caktuar lidhur me të, dhe se kësaj radhe do të mund të kalojmë konkretisht në sqarimin e gjërave të panjohura lidhur me materialin e parë dhe në punën e mundimshme po të shenjtë që na pret në të ardhmen." (Letër për Nuhi Sylejmanin, 10 shkurt 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 32)

37.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nëse është kthyer M., merrja ato pllakat e gramafonit dhe pyete a ka marrë gjë vesh lidhur me **shokun** H., pasi, me gjasë, M. ka qenë në shtëpi dhe, sipas informatave, është dashur të kthehej pardje." (Letër për Nuhi Sylejmanin, 10 shkurt 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 32)

38.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Besoj të kesh biseduar me **shokët** për ndihma që patëm thënë t'i mblidhnim për H. Po kështu, qysh tash ne duhet të mendojmë hollë e hollë se kush do të jetë njeriu i përshtatshëm, që do t'i dërgojë në vend ato, kur të mblidhen. Kjo ka rëndësi të madhe. Me shpresë se letra arrin me kohë, ju përcjellim të fala **vëllazërore**, ty dhe **shokëve**! "Lajmëtari"" (Letër për Nuhi Sylejmanin, 10 shkurt 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 32)

39.

Donika Gërvalla: "Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shoku** Vullnet, dhe të tjerë,

E mora letrën tuaj dhe listën e fjalëve të panjohura që duan shpjegim. Pikërisht për ta kryer këtë punë, ndenja në shtëpi dhe nuk dola sot të takohem me ju, sado që e dija se do të dilnit në Ludwigsburg." (Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

40.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Pos kësaj, mendoj që ka ardhur koha të caktojmë një njeri i cili do të realizojë kontaktin **me krahun e Lëvizjes në Kosovë**. Pra, kemi shumëçka për t'u marrë vesh." (Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

41.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Më njoftuat për demonstratat. Uashingtoni thotë se kanë qenë 500 demonstrues. „Frankfurter Allgemeine Zeitung" (data 12.03.1981) thotë se

demonstrata ka qenë e fuqishme, kurse pjesëmarrës kanë qenë 2000, disa **shokë** që gjoja e paskan dëgjuar me vëmendje Radio-Këlnin, thonë se Këlni paska thënë se kanë marrë pjesë 32 mijë demonstrues." (Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

42.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ndërkaq, me valën e parë të informatave, disa **shokë** nga Kosova na kanë dhënë njoftime jo të plota. Ata thonë se kanë qenë së paku 4000 demonstrues. Një polic është plagosur rëndë (gazeta gjermane thotë se ai ka vdekur), kurse prej djelmoshave tanë 13 janë të plagosur. Demonstratat kanë filluar të mërkurën më 11 mars 1981 në ora 17:00, dhe kanë vazhduar deri ditën e nesërme në ora 4. Së shpejti do të na arrijnë informata të hollësishme." (Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

43.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Lidhur me efektin e tyre do të flasim posaçërisht pasi të marrim informata të plota. Po një gjë dihet me siguri: ato kanë rëndësi shumë të madhe. E vërtetojnë edhe njëherë vitalitetin e popullit tonë dhe faktin se mes nesh dhe fashizmit jugosllav nuk do të ketë kurrë pajtim, deri te liria e plotë dhe bashkimi me vendin amë.
Përshëndetje shqiptare e komuniste – „Lajmëtari“" (Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

44.

Donika Gërvalla: "Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Bardhosh Gërvalla: "I dashur **Shoku** Nijazi,

dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gezuar, sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po presim ndonjë lajm nga **shoku** Bashkim Prishtina, për të cilin ju mund ta dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllau im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t`ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prapë këndej." (Letër Nijazi Strajës, mesi i marsit 1981; U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

45.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashuri **shok**, Bashkim!

Letrën tënde (një fjalë apo një shenjë sado të vogël) e kam pritur si qorri sytë. Siç do të shohësh pak më poshtë, ajo ka për mua një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, bile rëndësi jetësore." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

46.

Donika Gërvalla: "Kosova sot është e lirë. Kosova sot është Republikë. Shtet i pavarur dhe sovran. Është koha të flitet për të gjitha etapat e luftës për çlirimin e Kosovës dhe është koha që të flitet e tërë e vërteta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashuri **shok**, Bashkim!

Tani më lejo të të bëj një raport të shkurtër për punën time nga dita e arratisjes sime e këndej." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

47.

Donika Gërvalla: "Për Nënën Ajshe, së bashku me mixhën Bardhosh, ata mbesin djemtë e saj të dashur, vdekja e të cilëve ia rëndoi zemrën shumë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Puna e parë që bëra, u bëra një telefon **shokëve** të ambasadës shqiptare në Vjenë. I njoftova për çështjen time dhe i luta të më ndihmojnë me ndonjë këshillë për të mos bërë ndonjë gabim ideologjik a taktik gjatë strehimit tim në këtë vend kapitalist." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

48.

Donika Gërvalla: "Për Nënën Ajshe, së bashku me mixhën Bardhosh, ata mbesin djemtë e saj të dashur, vdekja e të cilëve ia rëndoi zemrën shumë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Pastaj, nga Kosova erdhi një student për vizitë dhe më solli një letër nga një i njohuri im i mëparshëm. Ky më njoftonte në letër se ishte pjesëtar i një organizate të vogël patriotike (unë atë person e dija për atdhetar) dhe, duke shprehur gatshmërinë e vet dhe të **shokëve** të vet për luftë të pakompromis për atdhe, më lutej që të merrnim kontakt dhe t'u delja në ndihmë me ndonjë këshillë a udhëzim. Unë, edhe lidhur me këtë e pashë të udhës të përgjigjem pozitivisht." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

49.

Donika Gërvalla: "Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Konkretisht në rrethinën e Shtutgartit janë nja 7 – 8 **shokë** të gatshëm e të përshtatshëm për punë patriotiko-revolucionare. Ata presin ndonjë orientim nga unë. Po unë duke qenë dhe vetë në mjegull për gjendjen time, nuk kam dashur t'i ngashënjej e pastaj t'i lë në gjysmë të rrugës. Prandaj u kam folur për gjëra të përgjithshme në çështje të organizimit, të propagandës dhe të agjitacionit si dhe kam bërë përpjekje për t'ua dhënë elementet e domosdoshme shkencore të historisë kombëtare dhe të lëvizjes **komuniste** shqiptare e ndërkombëtare. Janë punëtorë dhe ma ka marrë mendja se në radhë të parë u duhet një ngritje e tillë ideore, politike e shkencore." (Letër Sabri Novosellës,

14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

50.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me një **shok** të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe **shoku** me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim midis nesh dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërenditim veprimet." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

51.

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeçare ndaj Jusuf Gërvallës, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2009)

Jusuf Gërvalla: "Kur e mora letrën tënde të çmuar, unë isha duke përgatitur një trakt të gjatë për opinionin gjerman e zvicëran, kurse **shoku** i "Lirisë" e përgatit traktin për shqiptarët e mërguar "ekonomikë"." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

52.

Donika Gërvalla: "Kosova sot është e lirë. Kosova sot është Republikë. Shtet i pavarur dhe sovran. Është koha të flitet për të gjitha etapat e luftës për çlirimin e Kosovës dhe është koha që të flitet e tërë e vërteta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ja, pra, këto ishin disa nga punët dhe mendimet e mia në këtë situatë të vështirë. Tani, me shpresë se edhe për mua personalisht, në saje të mirëkuptimit të **shokëve**, do të ketë ndonjë ditë më të bardhë, po e përfundoj këtë letër dhe po të përcjell të fala shqiptare e revolucionare." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

53.

Donika Gërvalla: "Kosova sot është e lirë. Kosova sot është Republikë. Shtet i pavarur dhe sovran. Është koha të flitet për të gjitha etapat e luftës për çlirimin e Kosovës dhe është koha që të flitet e tërë e vërteta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Prandaj është mirë që qysh tani, **shokët** të mbledhin sa më shumë informata dhe, kur të formohen komitetet, t'i ushqejmë ato me të vërteta në shkallë sa më të gjerë.)

Tani, **vëlla** Mërgim, lejomë t'u përgjigjem disave nga pyetjet që shtron ti në letër. "Lajmëtarin e lirisë", siç të pata shkruar edhe më parë, e kam nxjerrë kryekëput vetë, bile, 80 për qind të shpenzimeve rreth botimit të tij i kam paguar vetë nga të ardhurat e mia dhe të **vëllaut**. Duke qenë puna kështu, është e natyrshme që niveli të mos ketë qenë në nivel dhe të jetë përvjedhur edhe ndonjë gabim. (Aq më parë, kur për shkrime kam qenë

i angazhuar edhe në gazetën “Bashkimi”.)" (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

54.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Se sa do të shpenzoheshin me variantin e parë dhe sa me të dytin, të informoj këto ditë në telefon, por e di se, për një punë më të rregullt në nxjerrjen e gazetës, do të duhej një ndihmë bukur e madhe financiare. Dhe unë nuk e di se sa keni mundësi, Ti me **shokët**, të ndihmoni së andejmi. Për shembull, një makinë për radhitje, me të gjitha llojet e germave ë përdoren në gazeta e libra e që prandaj s’ka si të identifikohet, e re kushton mbi 20 mijë mark, po e përdorur ka mundësi të gjendet edhe 10 mijë. E këto janë para të mëdha. Ndryshe, po të zgjidhet çështja e makinës, shpenzimet e shumëzimit të revistës do t’i përballoja vetë, me disa **shok**ë këtu, pa kurrfarë problemi." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

55.

Donika Gërvalla: "Kosova sot është e lirë. Kosova sot është Republikë. Shtet i pavarur dhe sovran. Është koha të flitet për të gjitha etapat e luftës për çlirimin e Kosovës dhe është koha që të flitet e tërë e vërteta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Këtu kam një propozim. Ai **shoku** në Mynhen, përmes të cilit e mora lidhjen me Ty, Shabani, është një milioner." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

56.

Donika Gërvalla: "Ua kemi borxh brezave të rinj që historinë t’ua përcjellim të pastër dhe pa legjenda. Dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për historinë e **Babit** tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Nëse **shokët** që ke Ti atje kanë ndikim në të, atëhere ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do t’i ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju.

Sido që të jetë, para se t’ia nis punës për nxjerrjen e “Zërit të Kosovës”, duhet të dija se deri në çfarë shkalle mund të më ndihmoni së andejmi materialisht." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

57.

Donika Gërvalla: "Ua kemi borxh brezave të rinj që historinë t’ua përcjellim të pastër dhe pa legjenda. Dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për historinë e **Babit** tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit ”Bashkimi”, më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku përsa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, nuk ekziston përshtypja

për organizim të mirëfillte dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që **shokëve të Lëvizjes në Kosovë** t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë." (Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

58.

Donika Gërvalla: "Ua kemi borxh brezave të rinj që historinë t'ua përcjellim të pastër dhe pa legjenda. Dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për historinë e **Babit** tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shok** Faredin!

Më fal që materialin e premtuar po jua dërgoj me vonesë. Por ashtu u bënë punët. Besoj se tani do ta merrni e ta shqyrtoni, bashkë me D.... Dhe pasi ta keni analizuar, të më përgjigjeni për sa qemë marrë vesh atë natë në mes vete. Ato që do t'i keni të paqarta, shënojini si dhe fjalët e pakuptueshme, e pastaj do t'i sqarojmë së bashku." (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 256)

59.

Donika Gërvalla: "Ua kemi borxh brezave të rinj që historinë t'ua përcjellim të pastër dhe pa legjenda. Dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për historinë e **Babit** tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashuri **shok**u Faredin!

Me pak vonesë po t'i dërgoi thirrjet për demonstrata, që do të mbahen këtë të shtunë në Dyzeldorf në ora 10,30 para stacionit hekurudhor. Njoftoi **shokët** aty përreth, por kishte me qenë mirë, sikur do të mundeshe t'i njoftosh edhe do **shokë** nga Tubingeni.

Sa i përket udhëtimit me autobusa, duhet të dihet përafërsisht numri i udhëtarëve dhe më lajmëro menjëherë, në mënyrë që kjo gjë të organizohet me kohë.

Në qoftë se të kanë ardhur edhe thirrje tjera nga "larg", kjo gjë mos të habit, dhe përmbaju këtyre thirrjeve këtu." (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 255-256)

60.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Sa i përket gjendjes në Kosovë, kemi informata se atje populli është i pamposhtur, dhe se lufta po vazhdon. **Shokët** na bëjnë me dije se demonstratat që po organizohen në botën e jashtme i kanë dhënë popullit shqiptar në " Kosovë" një frymëzim dhe një hov të madh...

Prandaj kjo gjë edhe neve na frymëzon edhe më tepër edhe na forcon vullnetin tonë, që të marrim pjesë sa më shumë në këto demonstrata." (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 255-256)

61.

Donika Gërvalla: "Ua kemi borxh brezave të rinj që historinë t'ua përcjellim të pastër dhe pa legjenda. Dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për historinë e **Babit** tim." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **shok**, Dini!

Ja dhe materialet që të premtova se do të t'i çoj. Në të parin " Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë", janë udhëzimet për disa çështje revolucionare në kushtet e punës ilegale. Ndërkaq, në materialin me titull " Si do të na përgjigjet armiku në pyetjet që do të shtrojmë ne, revolucionarët" , bën fjalë për rëndësinë e njërës nga fushëbetejat kryesore të organizatës revolucionare, pra për rëndësinë e shtypit revolucionar." (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 254-255)

62.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Po e përsërisim edhe një herë mënyrën se si duhet të lidhen anëtarët e celulës. Ti si anëtar celule ke të drejtë dhe detyrë të krijosh dy hallka – A dhe B. Hallka A dhe B të njohin ty, por jo edhe njëra tjetrën. Po kështu, pasi të jenë futur në celulë këto dy hallka dhe pasi të kenë dhënë ndonjë shenjë të sigurt se janë të pjekura për punë revolucionare në kushtet e caktuara prej nesh, secila prej tyre do të ketë të njëjta të drejta dhe detyra. U morrëm vesh edhe lidhur me atë se çfarë kushtesh kërkohen për angazhimin e një **shoku** etj. (Për çdo gjë të paqartë, drejtomu me letër ose bëjmë takim, sepse nuk duhet të ecim me gjëra të pasigurta në asnjë mënyrë.)" (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 254-255)

63.

Donika Gërvalla: "Unë mendoj që në atë kohë, në vitin 1982, unë e kam parë dosjen, nuk kanë munguar hetimet, hetimet i kanë shtrirë sa secila fjalë që ju ka arritur, qoftë me letër qoftë me telefon janë përpjekur ta sqarojnë dhe ta zgjidhin, por nuk i kanë pasur mundësitë, nuk i kanë pasur thjeshtë mekanizmat në dorë. Unë kam lexuar deklaratat e **miqve** të babait tim, të shqiptarëve tjerë që babai nuk i ka njohur." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Kur të kesh zgjidhur hallkat tuaja, kujdesu që njëri **shok** yti të jetë patjetër në vendlindje. Sepse, ne bëjmë pak, në qoftë se mbështetemi vetëm në **shokët** tanë që punojnë në botën e jashtme. Me rëndësi është që organizimi të marrë hov në vendlindje. Natyrisht, çështjen e takimeve me **shokët** e angazhuar në vendlindje, do ta shqyrtojmë bashkarisht dhe në hollësi." (Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 254-255)

64.

Donika Gërvalla: "Unë mendoj që në atë kohë, në vitin 1982, unë e kam parë dosjen, nuk kanë munguar hetimet, hetimet i kanë shtrirë sa secila fjalë që ju ka arritur, qoftë me letër qoftë me telefon janë përpjekur ta sqarojnë dhe ta zgjidhin, por nuk i kanë pasur mundësitë, nuk i kanë pasur thjeshtë mekanizmat në dorë. Unë kam lexuar

deklaratat e **miqve** të babait tim, të shqiptarëve tjerë që babai nuk i ka njohur." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **vëlla** Mërgim!

Po të vë në dijeni se vonesa e letrave nga ana ime nuk është, as çështje harrese e as çështje e neglizhencës. Po prirem nga dëshira që kur të Të shkruaj, të kem së paku diçka të rëndësishme për të të thënë." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

65.

Donika Gërvalla: "Unë mendoj që në atë kohë, në vitin 1982, unë e kam parë dosjen, nuk kanë munguar hetimet, hetimet i kanë shtrirë sa secila fjalë që ju ka arritur, qoftë me letër qoftë me telefon janë përpjekur ta sqarojnë dhe ta zgjidhin, por nuk i kanë pasur mundësitë, nuk i kanë pasur thjeshtë mekanizmat në dorë. Unë kam lexuar deklaratat e **miqve** të babait tim, të shqiptarëve tjerë që babai nuk i ka njohur." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Me **shokun** Sh. në Mynih nuk kemi biseduar gojarisht, po vetëm në telefon. Ai tha se do të më përgjigjet brenda një kohe të shkurtër, por ende nuk është përgjigjur. Ndërkaq te **shoku** I. në Visloh ishim. Na priti mirë. Por kohën e bisedës e kishim të kufizuar, se i erdhën mysafirë të tjerë. Paske marrë vesh për një bisedë të nxehtë, që u zhvillua në banesën e tij me atë rast me disa kopukë projugosllavë." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

66.

Donika Gërvalla: "Unë mendoj që në atë kohë, në vitin 1982, unë e kam parë dosjen, nuk kanë munguar hetimet, hetimet i kanë shtrirë sa secila fjalë që ju ka arritur, qoftë me letër qoftë me telefon janë përpjekur ta sqarojnë dhe ta zgjidhin, por nuk i kanë pasur mundësitë, nuk i kanë pasur thjeshtë mekanizmat në dorë. Unë kam lexuar deklaratat e **miqve** të babait tim, të shqiptarëve tjerë që babai nuk i ka njohur." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "E di që nuk kam bërë aq mirë që kam folur, por, unë e pata paralajmëruar **shokun** I. (Isa Bulan-shën i Xh.D.) të mos më ndalte, sepse nuk mund të durohen kur fliten muhalife." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

67.

Donika Gërvalla: "Unë mendoj që në atë kohë, në vitin 1982, unë e kam parë dosjen, nuk kanë munguar hetimet, hetimet i kanë shtrirë sa secila fjalë që ju ka arritur, qoftë me letër qoftë me telefon janë përpjekur ta sqarojnë dhe ta zgjidhin, por nuk i kanë pasur mundësitë, nuk i kanë pasur thjeshtë mekanizmat në dorë. Unë kam lexuar deklaratat e **miqve** të babait tim, të shqiptarëve tjerë që babai nuk i ka njohur." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Pos kësaj, ja lëshova frenin vetes pak më shlirshëm, duke ditur se **shoku** I. (Isa Bulan) nuk është aspak i varur nga Jugosllavia. Përveç kësaj, unë mendoj

se kjo gjë duhet të ketë pasur një efekt të mirë te **shoku** I. Ai e pati rastin të njihet me disa pikëpamje dhe me shkallën time të informimit; lidhur me realitetin kosovar. Po të bëj me dije se këto ditë arriti prej tij edhe shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij." (Letër për Sabri Novosellën, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271)

68.

Agron Bajrami: Menjëherë pas shkuarjes tuaj atje?

Donika Gërvalla: "Në vitin 1983 filluan të vinë grupet e para dhe natyrisht edhe ato ishin grupe mjaft të shoshituna para se t'ju lejohej të vinin në Shqipëri. Unë njoh mjaft **miq** të babait që nuk u është lejuar të vinin në ato rrethana në Shqipëri." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "*Në kufirin gjermano-zvicëran, Brahimit dhe Hysenit u ka zënë policia e huaj disa qindra ekzemplarë të "Bashkimit" dhe ua ka marrë. Me këtë rast, Ibrahimi nuk është treguar i gatshëm për të pranuar kritikat. Përgjithësisht, nëse ia numëron gjestet dhe punët e kritikueshme, ai thotë: "Mos m'u kap vetëm për disa gabime, të vogla". Menjëherë pas kësaj, bashkë me **shokët**, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovaki, në gjurmim të armëve (ndoshta profesori mund të ketë ndonjë informim nga ana e **shokëve** të Pragës lidhur me sjelljet e tyre në atë vend, sepse e di që **shokët** e Pragës kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshja me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.)."* (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" – **RAPORT** mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor, korrik 1981; U publikua nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

69.

Agron Bajrami: Menjëherë pas shkuarjes tuaj atje?

Donika Gërvalla: "Në vitin 1983 filluan të vinë grupet e para dhe natyrisht edhe ato ishin grupe mjaft të shoshituna para se t'ju lejohej të vinin në Shqipëri. Unë njoh mjaft **miq** të babait që nuk u është lejuar të vinin në ato rrethana në Shqipëri." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "***Shokët** e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre **shokëve**, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"* (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" – **RAPORT** mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor, korrik 1981; U publikua nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

70.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **vëlla** Mërgim!

Për mua, personalisht mendimet e tua kanë një domethënie të madhe. U mësova disi me to dhe se si më vjen keq kur i bie në fund së lexuari letrës sate, më vjen keq që

s'ka më shumë fjalë. Ndërkaq, për të gjithë ne, mendimet dhe këshillat e tua të urta janë bërë një impuls i mirë, që po na e shkund ndryshkun, në çastet që ky po kaplon punën tonë në këto kushte të vështira mërgimi dhe sidomos në një mjedis bashkatdhetarësh, me të cilët është punë tejet e vështirë të punohet (vështirësinë e kushtëzon natyrisht, edhe paaftësia jonë për komunikim të qëlluar.)" (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

71.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, e **unë, Shpendi e Besniku** jemi të kënaqur." (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

72.

Donika Gërvalla: "Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeçare ndaj Jusuf Gërvallës, vëllait të tij Bardhoshit dhe **mikut** Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla." (www.gervalla.org, 2009)

Jusuf Gërvalla: "Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e **Shpendit, e Besnikut** dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë." (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

73.

Agron Bajrami: Menjëherë pas shkuarjes tuaj atje?

Donika Gërvalla: "Në vitin 1983 filluan të vinë grupet e para dhe natyrisht edhe ato ishin grupe mjaft të shoshituna para se t'ju lejohej të vinin në Shqipëri. Unë njoh mjaft **miq** të babait që nuk u është lejuar të vinin në ato rrethana në Shqipëri." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Edhe **Shpendi edhe Besniku**, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne." (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

74.

Agron Bajrami: Menjëherë pas shkuarjes tuaj atje?

Donika Gërvalla: "Në vitin 1983 filluan të vinë grupet e para dhe natyrisht edhe ato ishin grupe mjaft të shoshituna para se t'ju lejohej të vinin në Shqipëri. Unë njoh mjaft **miq** të babait që nuk u është lejuar të vinin në ato rrethana në Shqipëri." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Mbrëmë ishim me **Besnikun te ai personi në Visloh**, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë." (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

75.

Agron Bajrami: Menjëherë pas shkuarjes tuaj atje?

Donika Gërvalla: "Në vitin 1983 filluan të vinë grupet e para dhe natyrisht edhe ato ishin grupe mjaft të shoshituna para se t'ju lejohej të vinin në Shqipëri. Unë njoh mjaft **miq** të babait që nuk u është lejuar të vinin në ato rrethana në Shqipëri." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "**Unë, Shpendi e Besniku**, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme. Na nevojitet mendimi juaj i prerë për të se ju keni ku e merrni këtë mendim." (Letër për Sabri Novosellën, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

76.

Donika Gërvalla: "Unë kur erdha fillimisht jetoja në Hamburg, por mjaft shpesh shkoja në Shtutgart sepse thjeshtë më tërhiqte varri i babait tim doja që për ato kohë që kisha jetuar në Shqipëri kur s'kisha pasur mundësi, doja që të jem sa më afër. Në këto udhëtimet e mia natyrisht që unë takoja **miq** të afërm të babait tim. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Gjermani në atë kohë ishte Hafiz Gagica, të cilin unë e njoh qysh kur ai ka qenë 19-20 vjeçar." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Më lejo të kalojmë te disa çështje mbi përgatitjen sa më të mirë të "Zërit të Kosovës" në të ardhmen.

Materialet që mendohet të sigurohen nga **shokë** të brendshëm, e do puna të na arrijnë gjithmonë me kohë, në mënyrë që të dalim me to me kohë para lexuesve, pa u humbur aktualiteti." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

77.

Donika Gërvalla: "Unë kur erdha fillimisht jetoja në Hamburg, por mjaft shpesh shkoja në Shtutgart sepse thjeshtë më tërhiqte varri i babait tim doja që për ato kohë që kisha jetuar në Shqipëri kur s'kisha pasur mundësi, doja që të jem sa më afër. Në këto udhëtimet e mia natyrisht që unë takoja **miq** të afërm të babait tim. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Gjermani në atë kohë ishte Hafiz Gagica, të cilin unë e njoh qysh kur ai ka qenë 19-20 vjeçar." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Kemi nevojë të madhe për materiale të nivelit profesionist, sidomos nga lëmi i historisë, i drejtësisë etj.

Për këtë qëllim, po shtroj këtu dy propozime:

Ne këndej, dhe **shokë** të tjerë në botën e jashtme, do të mund të siguronim një numër të caktuar adresash të vendësve. Këto adresa do t'u jepeshin në atdheun tonë njerëzve të penës. Ata do të na dërgonin në to shënime për ato që kanë ndodhur e po ndodhin në Kosovë : numrin, emrat dhe shënime përcjellëse, sa më të plota, për të vrarët,

të plagosurit, të arratisurit, të pushuarit nga puna, të burgosurit etj. Materialet do t'i lëshonin në posta jashtë trojeve shqiptare, është e dëshirueshme që ato të lëshohen në Slloveni, ku kontrolli policor duhet të jetë më i vogël." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

78.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Adresën e B. Krasniqit do ta sigurojmë dhe të ta dërgojmë sa më shpejt që të jetë e mundshme. Me K. (Kolë) Mërturin do të bisedojmë për ato që u morëm vesh, Djelmoshave të tjerë në Romë, Besniku u kishte lënë 200 dollarë, këtu e kemi një **shok** të njërit prej tyre dhe prandaj shpresojmë se do ta fitojmë besimin e tyre dhe t'i bëjmë **shokë** edhe ata." (Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

79.

Agron Bajrami: Para se të vazhdoj për punën e juaj në LDK në atë kohë më intereson të di pse nuk iu kthyet në Gjermani aktivitetit politik aty ku mbeti babai juaj me ata njerëz që tashmë ishin në LPK. Kishin krijuar atë strukturën të unifikuar të them ashtu. A patët komunikim me dike prej **shokëve** të babait?

Donika Gërvalla: "Pikërisht asaj strukture iu ktheva sepse **shokët** e afërt të babait tim, **miqtë** e babait tim ndodheshin tani në Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse jo vetëm Shqipëria dhe Evropa Lindore por edhe Kosova kishte bërë hapa të mëdhenj nga viti 1982 kur unë isha larguar për në Shqipëri, dhe për mu ishte surprizë mjaft e madhe ajo formë e re e komunikimit që ekzistonte mes tyre. Pra unë u ktheva pikërisht aty ku unë mendoja ta gjej babain tim dhe jo në Lëvizjen Popullore të Kosovës e cila kishte mbetur mjaft e kufizuar si numër sepse pjesa më e madhe e veprimtarëve të vjetër për Kosovën kishin shkuar dhe i ishin bashkangjitur Lidhjes Demokratike të Kosovës si lëvizje në Gjermani." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "I dashur **vëlla** Mërgim,

Në letrat e fundit na kanë ardhur disa këshilla nga ana juaj. Ta them të drejtën se mua personalisht më kanë lënë me një ndjenjë të ftohtë. Thelbi i tyre konsiston, sipas përshtypjes sime, në një tërheqje në vete, që u dashka të aplikohet prej nesh. Ose nuk kam qenë në gjendje ta kuptoj qartë. Se cilësia duhet të ketë përparësi ndaj sasisë, kjo dihet dhe për këtë kam shkruar edhe vetë, nëse të kujtohet, në atë Qarkoren drejtuar **shokëve** në D., që ti e ke pas pëlqyer." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

80.

Donika Gërvalla: "Nuk është ndonjë turp, nëse luftën e përbashkët për liri nuk e kufizon brenda rrethit të shokëve dhe **miqve** të ngushtë." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve,

ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët. **Kështu e pata kuptua më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit dhe timen në KQ**. Rinia jonë revolucionare po kërkon radhët e revolucionarëve të organizuar." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

81.

Agron Bajrami: Para se të vazhdoj për punën e juaj në LDK në atë kohë më intereson të di pse nuk iu kthyet në Gjermani aktivitetit politik aty ku mbeti babai juaj me ata njerëz që tashmë ishin në LPK. Kishin krijuar atë strukturën të unifikuar të them ashtu. A patët komunikim me dike prej **shokëve** të babait?

Donika Gërvalla: "Pikërisht asaj strukture iu ktheva sepse **shokët** e afërt të babait tim, **miqtë** e babait tim ndodheshin tani në Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse jo vetëm Shqipëria dhe Evropa Lindore por edhe Kosova kishte bërë hapa të mëdhenj nga viti 1982 kur unë isha larguar për në Shqipëri, dhe për mu ishte surprizë mjaft e madhe ajo formë e re e komunikimit që ekzistonte mes tyre. Pra unë u ktheva pikërisht aty ku unë mendoja ta gjej babain tim dhe jo në Lëvizjen Popullore të Kosovës e cila kishte mbetur mjaft e kufizuar si numër sepse pjesa më e madhe e veprimtarëve të vjetër për Kosovën kishin shkuar dhe i ishin bashkangjitur Lidhjes Demokratike të Kosovës si lëvizje në Gjermani." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Mendoj se Lëvizja duhet të përfshihet prej impulsesh të reja. Se cilat do të jenë këto impulse, unë nuk jam në gjendje ta them. Por, po të përpiqen **shokët**, do ta gjejnë doemos." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

82.

Agron Bajrami: Para se të vazhdoj për punën e juaj në LDK në atë kohë më intereson të di pse nuk iu kthyet në Gjermani aktivitetit politik aty ku mbeti babai juaj me ata njerëz që tashmë ishin në LPK. Kishin krijuar atë strukturën të unifikuar të them ashtu. A patët komunikim me dike prej **shokëve** të babait?

Donika Gërvalla: "Pikërisht asaj strukture iu ktheva sepse **shokët** e afërt të babait tim, **miqtë** e babait tim ndodheshin tani në Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse jo vetëm Shqipëria dhe Evropa Lindore por edhe Kosova kishte bërë hapa të mëdhenj nga viti 1982 kur unë isha larguar për në Shqipëri, dhe për mu ishte surprizë mjaft e madhe ajo formë e re e komunikimit që ekzistonte mes tyre. Pra unë u ktheva pikërisht aty ku unë mendoja ta gjej babain tim dhe jo në Lëvizjen Popullore të Kosovës e cila kishte mbetur mjaft e kufizuar si numër sepse pjesa më e madhe e veprimtarëve të vjetër për Kosovën kishin shkuar dhe i ishin bashkangjitur Lidhjes Demokratike të Kosovës si lëvizje në Gjermani." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Ne kemi vrarë mendjen se rruga më e sigurt për futjen e shtypit në Atdhe është shfrytëzimi i ndonjë transportuesi në relacionet evropiane. Juve ndoshta mund t'u vij përdoresh të gjeni ndonjë shofer shqiptar nga Turqia që bartë mall me kamion të madh prej shteteve evropiane, e që kalon nëpër Jugosllavi. Ne do t'ia jepnim që këtej materialin, kurse **shokët** brenda duhet të gjejnë mënyrën se si ta marrin prej tij në dorëzim atë material. Në rast të tillë neve do të na zvogëlohej problemi edhe sa i përket shtimit të tirazhit të revistës edhe shpeshtimit të daljes së saj, gjë që ka rëndësi të madhe."

(Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

83.

Agron Bajrami: Gjatë punës tuaj në LDK e takuat Ibrahim Rugovën? Çfarë ishin raportet me te?

Donika Gërvalla: "Unë Ibrahim Rugovën me siguri si fëmijë mund ta kem takuar por nuk e mbaj mend. Ndërsa për herë të parë e kam takuar në Shqipëri ditën që kam dalë nga greva e urisë të studentëve, në shkurt të vitit 1991. Atëherë ai së bashku me Ali Aliun, Bujar Bukoshin dhe Hafiz Gagicën kishin ardhur, ishte herë e parë që Rugova vinte në Shqipëri, dhe ndoshta, ai ka ardhur herët në mëngjes tek ne, do të thotë mund të ishte ndër vizitat e para që kanë bërë në Shqipëri. Unë kam parë që Rugova mua më konsideronte si vajzën e **shokut** dhe **mikut** të vjetër dhe unë kam folë me shumë gjerman që kanë qenë pjesë e strukturave shtetërore të cilët e njihnin rastin e babit dhe vrasjen dhe secilën herë më thonin se e di e di se presidenti Rugova kur ka qenë në Gjermani ka biseduar." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e **Shpendit**, për të mos thënë me presionin e tij, **Shpendi** shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri. Së andejmi u paraqit disa herë në telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm, a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

84.

Agron Bajrami: Gjatë punës tuaj në LDK e takuat Ibrahim Rugovën? Çfarë ishin raportet me te?

Donika Gërvalla: "Unë Ibrahim Rugovën me siguri si fëmijë mund ta kem takuar por nuk e mbaj mend. Ndërsa për herë të parë e kam takuar në Shqipëri ditën që kam dalë nga greva e urisë të studentëve, në shkurt të vitit 1991. Atëherë ai së bashku me Ali Aliun, Bujar Bukoshin dhe Hafiz Gagicën kishin ardhur, ishte herë e parë që Rugova vinte në Shqipëri, dhe ndoshta, ai ka ardhur herët në mëngjes tek ne, do të thotë mund të ishte ndër vizitat e para që kanë bërë në Shqipëri. Unë kam parë që Rugova mua më konsideronte si vajzën e **shokut** dhe **mikut** të vjetër dhe unë kam folë me shumë gjerman që kanë qenë pjesë e strukturave shtetërore të cilët e njihnin rastin e babit dhe vrasjen dhe secilën herë më thonin se e di e di se presidenti Rugova kur ka qenë në Gjermani ka biseduar." (www.kohavision.net, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "Tani po kthehem edhe njëherë në fillim të letrës. Mendimi im është se disa çështje parimore, siç është themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë, pastaj mënyra e organizimit të Lëvizjes në kushtet e reja të luftës, duhet të diskutohen e të pleqërohen më dendur me **shokët**, sidomos me Plakun. Jo vetëm gabimet e mëdha parimore, por edhe të voglat ka mundësi të evitohen shumë më mirë në këtë mënyrë. Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun. Në këtë pikëpamje ne jua

kemi lakmi, se këndej punët me relacione të tilla nuk janë aq të thelluara, jo për fajin tonë." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

85.

Donika Gërvalla: "Por e gjithë e vërteta është që unë nuk jam e vetmja që e di se sa të tensionuara ishin një kohë relatat mes Babit tim dhe Kadri Zekës. Ata **asnjëherë nuk arritën të bëheshin shokë**. Shkak për këtë mund të ishte edhe fakti që kishin përfytyrime të ndryshme, se cila do të ishte rruga më e mirë për arritjen e synimeve të përbashkëta." (Duhet thyer heshtja, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Jusuf Gërvalla: "Në fund, duke ju dërguar të fala **vëllazërore** e revolucionare, kërkoj falje për helmin e derdhur në këtë letër, por na helmuan ca problemet e përmendura dhe është e udhës t'i ndajmë bashkë." (Letër për Sabri Novosellën, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454)

JUSUF GËRVALLA DO TË MARRË IMPULSE TË REJA

Kadri Rexha: *"Gjatë kësaj kohe, pra në muajt e parë të vitit 1980, në jetën politike të Jusuf Gërvallës hyn edhe një ngjarje tjetër shumë me rëndësi, e cila në aktivitetin e tij të palodhshëm do t'ia plotësojë një boshllëk, do ta angazhojë edhe më tepër, sidomos kur të kihet parasysh se në mes Jusuf Gërvallës dhe organizatës së tij LNÇKVSHJ ende nuk ishin vënë kontaktet e pritura.* ***Ismail Haradinaj****, arsimtar i edukatës fizike, nga fshati Glloxhan, KK i Deçanit, përndryshe burrë i ndershëm nga një derë e njohur për tradita të larta patriotike, me anë të një letre, të cilën ia dërgon përmes një studenti, e njofton Jusuf Gërvallën se në rrethin e Deçanit ekziston një grup patriotik revolucionar mjaft aktiv. Ai përmes letrës shpreh gatishmërinë e vet dhe të shokëve të tij për luftë të pakompromis për atdhe. Prandaj, në mes tjerash, e lut Jusufin që të jetë në kontakt të vazhdueshëm me ta, në mënyrë që t'u gjendet sa më pranë me këshilla dhe udhëzime. Kësaj lutje dhe kërkesave që i erdhën nga ky grup, Jusuf Gërvalla u përgjigjet pozitivisht dhe menjëherë fillon nga puna. Sa për fillim ai atyre ua ofron Statutin, materialet e LNÇKVSHJ dhe mënyrën e organizimit të saj, të cilat ata i pranojnë me entuziazëm të madh. Pas përqafimit të Statutit, ky grup, më parë gjysmë i organizuar, i riorganizon radhët e veta dhe fillon një aktivitet me hov të ri. Tash e tutje ky krah i ri i LNÇKVSHJ do të quhet 'Komiteti i Deçanit' dhe pothuajse të gjitha territoret e Rrafshit të Dukagjinit si dhe Universiteti i Prishtinës pikërisht nga kjo degë do të mbulohen me trakte, si dhe me materiale të tjera patriotike. Nga puna dhe aktiviteti i suksesshëm i këtij krahu, Jusuf Gërvalla do të marrë impulse të reja, edhe pse me vështirësi të mëdha materiale dhe pa bashkëpunëtorë, do t'i hyjë punës individualisht dhe gjatë verës së atij viti do të fillojë me nxjerrjen e revistës së përdymuajshme 'Lajmëtari i lirisë'."* (Fati i luleve, Prishtinë, 1993, f. 162)

SHOKU QË DIKUR MË DINTE PËR PRIJËS UJËRASH

(Disa vargje nga poezitë e Jusuf Gërvallës)

do të ketë aty pak trosha buke do të zihet çaji
një komë e shtruar në mesore do gazeta dite
do të vë portretin e një dashurie në dhomën e pritjes
*do të më vijnë **shokë** e do të më vijnë prindër*

*

ka njerëz që tërë ditën fluturojnë çudi
ka njerëz që gjithë natën flenë nën ujëvara
lumit i besojnë si njeriut e flenë nganjëherë edhe pas dreke
njerëz me ballë të çiltër me shokë shumë e të dashur
e femra që i dashurojnë
ka njerëz të çuditshëm sot kudo në botë
ka varre për këta njerëz në tokën e shkelur të Kilit...

*

s'do t'i kthehem kurrgjësë as kotësisë së zezë
rrugës sime nga të largohem gjurmë do të lë
shtigjeve thepore nga vetja pas dhish
prore diçka mbetet për të ardhur se atje më pret
hapi i mendimit tim. Bucelë e verës e shelgjishtë
shoku që dikur më dinte për prijës ujërash
bërrakat e bari i keq me gjarpinj - aty janë

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014

21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror."* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Shkurt 2013-Shkurt 2026